	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 1 nga 78</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>	

OPERATOR SISTEMI TRANSMISIONI DHE TREDI KOSTT J.S.C.
 TRANSMISSION SYSTEM AND MARKET OPERATOR KOSTT J.S.C.
 OPERATOR SISTEMA PRENOSJA I TRAZISTA KOSTT d.d.
 Nr. 171 Dt. 17.03.2014
 PRISHTINË-A

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
 Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
 Ministria e Zhvillimit Ekonomik / Ministarstvo Ekonomskog Razvoja
 Ministry of Economic Development
 Nr. Prot. Org. Jedin. Org. Unit: 0113 Nr. Prot. Prot. No.: 534
 Nr. i fletëve Broj stranic: No. pages: 17.03.2014
 Datum Date: 17.03.2014
 PRISHTINË/A

KOSTT


Raport Vjetor 2013

(01.01.2013-31.12.2013)

Vendimi - 140313-II/5


Bordi i Drejtorëve në mbledhjen e 49/14 të datës 13 mars 2013 njëzëri me vërejtjet e dhëna miratoi raportin vjetor për vitin 2013.

	Delegoi	Aprovoi
Emri Mbiemri	Naim Bejtullahu, Kryeshef Ekzekutiv	Ramadan Paçarada, u.d.Kryesues i Bordit të Drejtorëve
Nënshkrimi		
Data	13.03.2014	13.03.2014


	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 2 nga 78</i>
Departamenti Financiar		Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti

**Raport Vjetor për Bordin e Drejtorëve në KOSTT
Periudha Janar - Dhjetor 2013**

1	Titulli i Dokumentit	Raport Vjetor 2013
2	Dërguesi i dokumentit	Naim Bejtullahu, Kryeshef Ekzekutiv
3	Përmbajtja e Raportit	<p>Përmbajtja Fjala hyrëse e Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve të KOSTT Fjala hyrëse e Kryeshefit Ekzekutiv të KOSTT</p> <p>1. Raporti i Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve 1.1. Aktivitete kryesore të ndërmara gjatë vitit 1.2. Komisionet e Bordit dhe përbërja 1.3. Të dhënat për drejtorët jo-ekzekutiv 1.4. Pasqyra e performancës operative dhe financiare në krahasim me vitin paraprak dhe plani i vitit aktual 1.5. Ngjarjet të cilët kanë ndikuar në funksionimin e KOSTT-it 1.6. Pasqyrë e të priturve për vitin e ardhshëm 1.7. Infomacionet lidhur me kapitalin dhe dividendën 1.8. Investimet e rëndësishme të bëra gjatë vitit</p> <p>2. Raporti i Kryeshefit Ekzekutiv 2.1. Arritjet kryesore 2.2. Ngjarjet kryesore të vitit 2.3. Pasqyrë e performancës operative dhe rezultatet e indikatorëve kyç të performancës 2.3.1. Balanca e planifikuar dhe e realizuar për Janar-Dhjetor 2013 2.3.2. Indikatorët Kyç të Performancës – operimi i sistemit 2.3.3. Indikatorët Kyç të Performancës - operimi i transmisionit 2.3.4. Operimi i tregut 2.3.5. Pasqyra e performancës financiare dhe rezultatet 2.3.6. Analiza e IKP-ve financiare 2.4. Progresi me planin e biznesit 2.5. Realizimi i projekteve kryesore kapitale gjatë vitit 2013 2.6. Perspektiva për vitin e ardhshëm 2.7. Rreziqet</p>

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 3 nga 78</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

		<p>Anekset</p> <p>1. Sponzorimet dhe donacionet</p> <p>4. Raportimet sipas Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike</p> <p>4.1. Pasqyra e strukturës organizative dhe ndryshimet gjatë vitit</p> <p>4.2. Përmbledhja dhe përshkrimi i procedurave gjyqësore</p> <p>4.3. Kontratat/transakcionet e konsiderueshme gjatë vitit 2013 nga burimet e KOSTT</p> <p>4.4. Sugjerime dhe propozime për rritjen e performancës</p> <p>Lista e shkurtesave</p>
4	Data e Raportimit	

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 4 nga 78</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>


Hyrje

Ky Raport Vjetor për vitin 2013 është përpiluar bazuar në dispozitën e nenit 31.3 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike. Sipas këtij Ligji, brenda 45 ditëve pas përfundimit të vitit kalendarik, zyrtarët e NP-së do të përgatisin një raport vjetor i cili i dorëzohet Bordit të Drejtorëve të KOSTT-it për miratim.

Ky Raport është punuar sipas formës së aprovuar nga Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike dhe sipas “Udhëzuesit për përpilimin e Raportit Vjetor të Ndërmarrjes Publike”.

Pas aprovimit të këtij Raporti nga Bordi i Drejtorëve të KOSTT-it, Raporti dërgohet në Njësinë për Politika dhe Monitorim të NP-ve.

Raporti paraqet rezultate kryesore të aktiviteteve të Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) në përmbushjen e detyrave dhe obligimeve gjatë vitit 2013 si dhe të aktiviteteve krahasuar me Planin e Biznesit, planin vjetor dhe shkallën e realizimit, respektivisht, implementimin e Planit të Biznesit.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>fajqe 5 nga 78</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

Fjala hyrëse e Kryesuesit të Bordit të KOSTT-it

Gjatë vitit 2013 KOSTT ka vazhduar performancën pozitive të afarizmit e cila është karakterizuar me zhvillime të shumta, si në aspektin zhvillimor ashtu edhe në çështjet e integritimeve regionale.

Sa i përket zhvillimit të infrastrukturës së transmisionit KOSTT tanimë ka kaluar tërësisht në vetëfinancim dhe gjatë vitit 2013 është nënshkruar kredia e dytë me Bankën zhvillimore gjermane KfW për financimin e projekteve në rrjet. Për më tepër, janë iniciuar bisedat me Bankën Evropiane për Zhvillim (BERZh) për financimin e projekteve investive gjatë periudhës së ardhshme.

Në anën tjetër KOSTT ka vazhduar angazhimin për integrimin në mekanizmat dhe proceset regjionale, si angazhimin për themelimin e Zyrës për Alokim të Koordinuar të kapaciteteve interkonektive në Evropën juglindore, dhe përgatitjen e infrastrukturës për t'i plotësuar kritetet për anëtarim në ENTSO-E.

Një ndër projektet të cilat vlen të theksohet është edhe projekti i rëndësisë së veçantë për Republikën e Kosovës – Linja interkonektive 400kV Kosovë – Shqipëri dhe projekti i Rregullimit Frekuencë – Fuqi, e të cilat do mundësojnë shkëmbim më të madh të energjisë me Republikën e Shqipërisë dhe rajonin, si dhe optimizimin e operimit të sistemit.


Bordi i Drejtorëve të KOSTT në funksion të përmbushjes së detyrave të veta në vazhdimësi ka monitoruar zhvillimet në kompani duke i krahasuar ato me objektivat e përcaktuara me Planin e biznesit dhe dokumentet tjera. Kontribut të rëndësishëm lidhur me këtë kanë dhënë edhe Komisionet funksionale të Bordit të Drejtorëve të cilat për së afërmi kanë përcjellur zhvillimet në lëmi të caktuara dhe kanë ofruar rekomandimet dhe mbështetjen e vet lidhur me këto procese.

Në përfundim, edhe aspekti financiar i afarizmit ka treguar rezultate të kënaqshme gjatë vitit 2013, ku vlen të përmendet se KOSTT ka deklaruar dhe paguar dividendë për aksionarin në vlerë prej 3 milion euro.

Bordi i Drejtorëve mbetet i zotuar dhe fuqishëm beson se sukseset e KOSTT nuk do të mungojnë as në vitin 2014 dhe shpreh mirënjohjen për të gjithë punonjësit dhe menaxhmentin e KOSTT sh.a.

Ramadan Paçarada

U.d. Kryesues i Bordit të Drejtorëve të KOSTT sh.a.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>fajqe 6 nga 78</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

Fjala e Kryeshefit Ekzekutiv të KOSTT

KOSTT edhe gjatë vitit 2013 ka vazhduar rrugëtimin në konsolidimin e infrastrukturës së transmisionit dhe angazhimeve për zhvillimin e platformës për të mundësuar integrimin në mekanizmat rajonal dhe evropian, duke implementuar projekte dhe iniciativa për të garantuar siguri të furnizimit dhe shërbime kualitative për shfrytëzuesit e sistemit të transmisionit.

Në periudhën e kaluar janë ndërmarrë shumë aktivitete në përfundimin e projekteve në vazhdim, si dhe fillimin e implementimit të projektit për Linjën interkonektive 400kV Kosovë – Shqipëri dhe projektin e Rregullimit Frekuencë – Fuqi, të cilat ndjeshëm do të kontribuojë në optimizimin e sistemeve të të dy vendeve dhe zhvillimit ekonomik. Të dy këto projekte në vitin 2013 janë kontraktuar për zbatim.


Implementimi i suksesshëm i projekteve kapitale, do të ndihmojë në përmbushjen e objektivave themelore të vendosura nga KOSTT, të cilat janë në pajtueshmëri të plotë me kërkesat teknike që dalin nga aktet e ENTSO-E.

Marrëveshjet për operim me Serbinë dhe Maqedonin janë negociuar në vitin 2013 dhe priten të firmosen në kuartalin e parë të vitit 2014 dhe kështu kompletohen marrëveshjet e interkonjeksionit me shtetet fqinje (marrëveshjet me Shqipërinë dhe Malin e Zi janë nënshkruar më heret). Marrëveshja me Serbinë për energji e firmosur në mes të Kryeministrave të Kosovës dhe Serbisë e promovon KOSTT si operator i njohur ndërkombtarisht që sanksionohet me Marrëveshtjen për Operim.

Performanca e operimit të sistemit të transmisionit në vitin 2013 është mjaft e mirë dhe tregon përmirësime të vazhdueshme krahasuar me vitin paraprak. Linjat dhe nënstacionet janë mirëmbajtur sipas planit të paraparë, janë realizuar kontrollimet/inspektimet e nënstacioneve dhe linjave, janë realizuar remontet e rregullta vjetore të fushave nëpër NS dhe janë bërë energjizimet e NS-ve, duke përfshirë komisionimin dhe testimin e mbrojtjeve rele, si dhe implementimin e projekteve të rëndësishme.

Edhe pse në vitin 2013, humbjet në transmision janë rritur në krahasim me vitin 2012 për 1.68%, kjo rritje e humbjeve në transmision, në kushtet kur konsumi është rritur vetëm për 0.5%, arsyetohet me ndryshimin e kufirit të transmisionit, kur të gjitha NS 110/x (kV) nga Rrjeti i Shpërndarjes së KEK-ut kanë kaluar në Rrjetin e Transmisionit. Humbjet në transmision megjithatë janë për 0.78% më të vogla se ato të lejuara nga ZRRrE.

Funksionet operative në monitorimin dhe veçmas në operimin e sistemit në kohën reale, janë avansuar, ndërsa Sistemi infrastrukturor SCADA\EMS i Telekomit dhe Matjeve komerciale ofrojnë mundësi shumë më të avansuara për operim të sigurisë së lartë.


	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 7 nga 78</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

Gjatë vitit 2013, KOSTT ka punuar në zhvillimin e strategjisë për hyrje në tregun e telekomunikimeve, duke ofruar tepriçën e kapaciteteve fiber optike. Në këtë drejtim, Bordi i Drejtorëve të KOSTT-it, muar vendimin për iniciimin e aktiviteteteve për aplikim për autorizim/licencë për Operator të shërbimeve të infrastrukturës në tregun e telekomunikimeve, kërkesë kjo e cila është aprovuar nga ana e Autoritetit Rregullativ të Telekomunikimeve Elektronike e Postare (ARKEP) të Kosovës.

Edhe për vitin 2012, për të shtatën herë radhazi, raporti i auditorit të jashtëm për pasqyrat financiare është pa asnjë kualifikim, që reflekton punën profesionale dhe përkushtimin e KOSTT në zbatimin e standardeve më të larta në proceset e punës dhe përmbylljen me shumë sukses të shfrytëzimit të të gjitha resurseve të KOSTT.

Përqëndrimi i KOSTT gjatë periudhës së ardhshme do të jetë i orientuar në sigurimin e qëndrueshmërisë afariste dhe zhvillimin e shkathtësive të punonjësve të KOSTT, të cilët janë forca shtytëse për zhvillimin e kompanisë dhe të vendit.

Naim Bejtullahu,
Kryeshefi Ekzekutiv

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 8 nga 78</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

1. Raporti i Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve

1.1. Aktivitete kryesore të ndërmarra gjatë vitit

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2013 KOSTT-i ka zhvilluar aktivitete të ndryshme të qeverisjes korporative bazuar në Ligjin nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike. Aktivitetet kryesore në këtë aspekt përfshijnë aktivitetet e Bordit të Drejtorëve, Komisionit të Auditimit dhe Komisioneve të tjera që Bordi i ka themeluar për nevojat e KOSTT-it.

Me 13 mars 2013 Qeveria e Republikës së Kosovës ka nxjerrë vendimin numër 01/119 me të cilin KOSTT përcaktohet si Kompani Publike e kategorise se pare.

Procesverbalet nga mbledhjet e Bordit, të Komisionit të Auditimit dhe të Komisioneve të tjera, raportimi dhe dërgimi i infomatave Njesisë së Monitorimit të Ndërmarrjeve Publike (NJPMNP) siç kërkohen sipas nenit 31, 32 dhe 37 të Ligjit për NP, janë kryer në mënyrë të rregullt dhe sipas afateve ligjore. Gjatë vitit 2013 Bordi i Drejtorëve të KOSTT-it ka mbajtur gjithësejt 12 mbledhje të rregullta dhe 2 mbledhje të jashtëzakonshme, si dhe mbledhjen e përgjithshme vjetore me aksionarin.


Çdo mbledhje e rregullt e Bordit ka trajtuar disa pika që paraqiten si pika të zakonshme dhe përfshijnë: Vërtetimin e kuorumit dhe aprovimin e rendit të ditës, miratimin e procesverbalit nga mbledhja paraprake e Bordit të Drejtorëve, Shqyrtimin e Raportit të Komisionit të Auditimit dhe Komisioneve të tjera dhe Informatën rreth aktiviteteve nga Zyra e Kryeshefit Ekzekutiv (KE) të KOSTT-it.

Në çdo mbledhje Bordi ka shqyrtuar dhe aprovuar raportin e Komisionit të auditimit dhe rekomandimet, si dhe raportet e Komisioneve të përkohshme siç janë: Komisioni për investime kapitale, Komisioni për shqyrtimin e operimit, dhe Komisioni për legjislacionin dhe përcjelljen e kontesteve ligjore.

Raportet nga mbledhjet e Komisionit të Auditimit dhe Komisioneve të themeluara nga Bordi janë prezantuar si materiale në mbledhjet e Bordit dhe janë dërguar në NJPMNP.

Në tabelën më poshtë janë paraqitur vendimet kryesore që janë aprovuar nga Bordi i Drejtorëve gjatë vitit 2013 duke mos i përfshirë mbledhjet dhe konsultimet e Zyrtarëve të Kompanisë, respektivisht Kryeshefit Ekzekutiv, Zyrtarit Kryesor Financiar, Sekretarit të Kompanisë dhe Auditorit të Brendshëm me Bordin dhe Zyrtarët e Njesisë së Monitorimit të Ndërmarrjeve Publike, raportimet dhe aktivitetet e ngjashme korporative.

Nr.	Vendimet e Bordit për aprovimin e dokumenteve si vijon:
1	Raport tremujor për periudhën Tetor –Dhjetor 2012, Raport tremujor për periudhën Janar – Mars 2013, Raport tremujor për periudhën Prill-Qershor 2013 dhe Raport tremujor për periudhën Korrik-Shtator 2013 (bazuar në nenin 31 të Ligjit për NP)

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>fajqe 9 nga 78</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>


2	Raporti i Komisionit për regjistrimin e pasurisë të KOSTT-it për vitin 2012 (Elaborati i regjistrimit të asetëve)
3	Plani i Biznesit 2013-2017
4	Plani Investiv 2013-2017
5	Plani Zhvillmor i Transmisionit 2013-2022
6	Plani i punës së Bordit të Drejtorëve (BtD) dhe Komisionit të Auditimit për vitin 2013
7	Raporti Vjetor i punës së KOSTT-it për vitin 2012
8	Inicimi i bisedimeve për Kredi me KfW
9	Marrëveshja për Kredi me BERZh
10	Politika për Arkivën
11	Raporti i Auditorit të Jashtëm për Pasqyrat Financiare Rregullative për vitin 2012
12	Plani i Biznesit i reviduar për vitin 2013
13	Manuali për Vlerësimin e Rrezikut në vendin e punës
14	Plani i biznesit për vitin 2014
15	Buxheti për vitin 2014
16	Plani i Prokurimit për vitin 2014
17	Vendimi për Emërimin e Kryeshefit Ekzekutiv

1.2. Komisionet e Bordit dhe përbërja

Gjatë vitit 2013 Komisioni i Auditimit ka vlerësuar të gjitha raportet tremujore, raportin vjetor të vitit 2012, Raportin e Auditorit të Jashtëm në KOSTT, raportet e auditorit të brendshëm, propozim Buxhetin për vitin 2013, revidimin e buxhetit për vitin 2013, Planin e Biznesit për vitin 2013, politikat, Planin e Auditimit të Brendshëm për vitin 2014, Planin e prokurimit dhe raporte të tjera.

Komisioni i Auditimit ka mbajtur gjithsejtë 14 mbledhje.

Përbërja dhe struktura e Komisioneve të përkohshme të Bordit është si vijon:

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 10 nga 78</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

Komisioni për investime kapitale

1. Nazmi Mikullovc, Kryesues
2. Ramadan Paçarada, Anëtar
3. Lutfi Maxhuni, Anëtar

II. Komisioni për operim

1. Fatos Ukaj, Kryesues
2. Nazmi Mikullovc, Anëtar
3. Ramadan Paçarada, Anëtar

III. Komisioni për legjislacion dhe përcjelljen e kontesteve ligjore

1. Lutfi Maxhuni, Kryesues
2. Fatos Ukaj, Anëtar
3. Faton Deda, Anëtar

Komisioni për investime kapitale ka mbajtur tri (3) mbledhje.

Komisioni për shqyrtimin e operimit ka mbajtur tri (3) mbledhje

Komisioni për legjislacion dhe përcjelljen e kontesteve ligjore ka mbajtur tri (3) mbledhje

Drejtorët e Bordit në KOSTT në vazhdimësi kanë qenë në komunikim dhe bashkëveprim me menaxhmentin e KOSTT-it, që ka rezultuar me efikasitet më të madhe në marrjen e vendimeve të nevojshme.

1.3. Të dhëna për drejtorët jo-ekzekutiv

Gjatë vitit 2013 Bordi i Drejtorëve të KOSTT-it ka qenë në përbërje si vijon:

Ramandan Paçarada, (u.d) Kryesues i Bordit të Drejtorëve të KOSTT-it (Anëtar i Komisionit të Auditimit, Kryetar i Komisionit për projekte kapitale; anëtarë i Komisionit për investime kapitale, anëtar i Komisionit për shqyrtimin e operimit), me profesion: ekonomist


Gjithsejtë kompensimet 2013: 17,927.Euro (Bruto)

Faton Deda, Anëtar i Bordit të Drejtorëve të KOSTT-it dhe anëtar i Komisionit për shqyrtimin e operimit, me profesion: inxhinier

Gjithsejtë kompensimet 2013: 12,842.91. Euro (Bruto)

Fatos Ukaj, Anëtar i Bordit të Drejtorëve të KOSTT-it; Kryesues i Komisionit të Auditimit; kryesues i Komisionit për shqyrtimin e operimit; anëtar i Komisionit për legjislacion dhe përcjelljen e kontesteve ligjore; me profesion: ekonomist - profesor universitar.

Gjithsejtë kompensimet 2013: 16,872.9 Euro (Bruto)

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 11 nga 78</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

Lutfi Maxhuni, Anëtar i Bordit të Drejtorëve të KOSTT-it; kryesues i Komisionit për legjislacion dhe përcjelljen e kontesteve ligjore; anëtar i Komisionit për investime kapitale; me profesion: ekonomist

Gjithsejtë kompensimet 2013: 14,594.3 Euro (Bruto)

Nazmi Mikullovc, Anëtar i Bordit të Drejtorëve të KOSTT-it; kryesues i Komisionit për investime kapitale; anëtarë i Komisionit për shqyrtimin e operimit ; me profesion: inxhinier

Gjithsejtë kompensimet 2013: 14,550.5 Euro (Bruto)

1.4. Pasqyra e performancës operative dhe financiare në krahasim me vitin paraprak dhe plani i vitit aktual

Gjatë vitit 2013, performanca operative e KOSTT-it është mjaft e mirë dhe tregon përmirësime të vazhdueshme krahasuar me vitin 2012. Zhvillimi i rrjetës transmetuese ka vazhduar. Kapaciteti instalues i transformatorëve në rrjetën 400-220 kV; 400-110 kV ka ngelë në nivelin e njëjte si në vitin paraprak (1800 MVA). Nuk ka pasur prishje të transformatorëve, është zvogëluar numri i prishjeve në linja dhe nuk ka pasur prishje me ndikim në sistemin e kontrollit, monitorimit, telekomunikimit, mbrojtjes në rrjetin transmetues.

Krahasuar me 2012, vlera mesatare e devijimeve për 2013 : si import ka qenë për 14,75% më e vogël se sa në vitin 2012, ndërsa në eksport për 1,5% më e vogël¹

Poashtu, edhe performanca financiare e KOSTT-it është mjaft e mirë, dhe më detalisht është paraqitur në Pikën 2.3.5. të këtij Raporti.


KOSTT ka arritur caqet e parashtruara në objektivat e Planit të Biznesit për vitin 2013 dhe IKP-të e performancës operative dhe financiare janë pozitive. Këta parametra të performancës së KOSTT-it janë vlerësuar rregullisht nga Bordi i Drejtorëve.

1.5. Ngjarjet të cilët kanë ndikuar në funksionimin e KOSTT-it

Ngjarjet të cilat kanë ndikuar në funksionimin e KOSTT-it paraqesin njëkohësisht edhe risqet me të cilat KOSTT-i ballafaqohet dhe që në mënyrë direkte afektojnë funksionimin e KOSTT-it.

a) Çështja e pazgjidhur e transitit dhe alokimit të kapaciteteve interkonektive me vendet fqinje si pasojë e marrëdhënieve të pazgjidhura me Serbinë.

¹ këtu fjala «import» nënkupton tërheqje e pa autorizuar nga sistemi, ndërsa «eksport» shtyerje e pa autorizuar në sistem

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 12 nga 78</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

b) KOSTT nuk është duke e kontrolluar plotësisht operimin e transmisionit në pjesën veriore të Mitrovicës si pasojë e mosdëgjueshmërisë së operatorëve në nënstacionin Vallaq dhe involvimit jolegal të operatorit të sistemit EMS nga Serbia.

c) Marrëveshja e firmosur për energji në mes të Kosovës dhe Serbisë ka qartësuar që KOSTT do të ketë përgjegjësit nga pikat a) dhe b) dhe implementimi pritet të ndodh gjatë vitit 2014.

d) KOSTT është duke aplikuar në Asociacionet ndërkombëtare të Operatorëve të Sistemeve të Transmisionit (ENTSO-E), me të cilët operojmë në mënyrë sinkrone, gjë e cila na mundëson ndër të tjera edhe pjesëmarrjen në mekanizmat e përbashkëta që valorizojnë çdo transaksion ndërkufitar. Valorizimi i aranzhmaneve ndërkufitare mund ti sjellë të hyra në dobi të KOSTT-it dhe konsumatorëve të Kosovës. Mospranimi i mundshëm i KOSTT në ENTSO-E është një rrezik i mundshëm.

1.6. Pasqyrë e të priturve për vitin e ardhshëm


Duke u nisur nga roli, misioni dhe vizioni i KOSTT, në Planin e Biznesit janë përcaktuar objektivat strategjike. Në mesin e tyre është edhe objektiva që KOSTT të jetë punëdhënës atraktiv, dhe me qëllim të plotësisht të këtij objektivi, do të vazhdohet edhe më tutje me punën e suksesshme për krijimin e një ambienti për investimin në zhvillimin profesional të punëtorëve dhe motivimin e tyre në arritjen e performancës së standardeve më të larta. Poashtu, me qëllim të ngritjes së performancës së sistemit të transmisionit, KOSTT do të vazhdojë me mirëmbajtjen e rrjetit transmetues dhe avancimin e funksioneve të operimit të sistemit të transmisionit. Në të njëjtën kohë, do të vazhdojë krijimi i kushteve për operimin e tregut në pajtim me zhvillimet e pritura të tregut. Për sa i përket zhvillimeve të tregut të energjisë elektrike, Dizajni i Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës (DTEEK) është miratuar nga ZRrE në mars 2013, ndërsa Drafti Final i Rregullave të Tregut është dorëzuar aprovuar në dhjetor.

Në përgjithësi se sa, dhe a do të implementohen kërkesat nga dizajni i ri i tregut gjatë periudhës kohore të këtij plani, do të varet nga pjesëmarrësit në këtë treg dhe kapacitetet e tyre për të ofruar produktet që ky treg i kërkon (balansimi, tregu i çastit etj.)


KOSTT do të përpiqet që edhe gjatë vitetve në vijim, të sigurojë qëndrueshmërinë e vet financiare dhe të vazhdojë të funksionojë si një organizatë efektive dhe efikase e cila gjithnjë punon në përmirësimin e performancës së punës.

KOSTT-i, bazuar në Planin e Biznesit, pritet të merr pjesë aktive në operimin dhe zhvillimin e tregut rajonal dhe në këtë mënyrë të përfitojë dhe të kontribuojë nga zhvillimi rajonal dhe në mekanizmat ndërkombëtare. Në këtë aspekt vlen të ceket edhe synimi i KOSTT-it që të antarësohet në ENTSO-E dhe të bëhet pjesëmarrës në mekanizmat tjerë ndërkombëtarë.

Me që KOSTT është dhe do të mbetet edhe më tutje një organizatë e përgjegjshme në aspektin social dhe mjedisor, ka për detyrë e krijimin e një ambienti të sigurt pune, si dhe zhvillimin e marrëdhënieve efektive me palët e interesit.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 13 nga 78</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

E gjith kjo dëshmon se edhe gjatë vitit që vjen, të gjitha resurset njerëzore dhe materiale do të jenë të orientuara drejt përmbushjes së objektivave strategjike, në përputhje me rolin, misionin dhe vizionin e KOSTT.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 14 nga 78</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

1.7. Infomacione lidhur me kapitalin dhe dividendën

Kapitali themeltar i KOSTT-it në momentin e regjistrimit ka qenë 25.000 (njëzetepesëmijë) Euro dhe është i ndarë në 25.000 aksione me vlerë nominale 1 Euro secili. Kapitali i Shoqërisë është deklaruar dhe paguar tërësisht në momentin e themelimit të KOSTT-it .

Aksionari i vetëm i KOSTT-it është Qeveria e Republikës së Kosovës.

Struktura e kapitalit është paraqitur në tabelën vijuese:

DRAFT PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL				
Perfundimisht 01.01.2013-31.12.2013.				
	Kapitali aksionar	Kapitali i trashëguar	Fitimi i mbajtur	Total
	----- EUR -----			
Kapitali aksionar në para	(25)			25
kontributet tjera jo para		(53,172)		53,172
Fitimi për periudhën e mëhershme				15,157
Fitimi i muajve të mëhershëm				-
Shtesat e share premium				
Fitimi për periudhë			3,805	3,805
Bilanci me DATA	(25)	(53,172)	3,805	72,160


1.8. Investimet e rëndësishme të bëra gjatë vitit

Në KOSTT gjatë vitit 2013 janë bërë përgatitjet për investime dhe investime të shumta bazuar në Planin zhvillimor, që janë përcaktuar në Planin e Biznesit për vitin 2013.

Më poshtë janë përmendur projektet investive, ndërsa statusi i tyre, burimet e financimit të projekteve dhe detajet janë pjesë e këtij Raporti.

Gjatë vitit 2013 KOSTT ka investuar në projektet që janë vazhdimësi nga vitet paraprake 2011/2012

1. Paket Projekti SCADA/EMS & Telekom: LOT-1:SCADA/EMS;
2. Paket Projekti SCADA/EMS & Telekom: LOT-2: Telekom;
3. Ndërrimi i përçuesit, izolatorëve dhe paisjeve lidhëse në LP 125/2 dhe 125/3;

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 15 nga 78</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

4. Kycja e NS Lipjanit në linjën LP 212 (Kosova A - Ferizaj 2);
5. Rialokimi i linjës 110kV, nr.1806 NS Gjakova 1-Gjakova 2 dhe Rehabilitimi i Pajisjeve të TL në NS Gjakova 1;
6. Rehabilitimi i pajisjeve të tensionit të lartë 110 kV në NS Gjilani 1 dhe NS Ferizaj 1;
7. Instalimi i dy fushave të reja të linjave 110 kV në NS Prizreni 2;

Projektet e reja, të cilat kanë filluar me implementim në vitin 2013 janë paraqitur më poshtë:


8. Shërbimet konsulent & Ndërtimi i linjës 400 kV RKS - AL - LOT 1;
9. Shërbimet konsulentë & Ndërtimi i linjës 400 kV Fusha e TL dhe LFC - LOT 2;
10. Rehabilitimi i stabilimenteve të TL në NS Gjakova 2 dhe Prizreni 3;
11. Rehabilitimi i Shtyllave të LP.2298 220kV me Nr.24 dhe 25 dhe LP.1806 110kV me Nr.31 dhe 32;
12. Ndërtimi i rrethojës së re në NS 400/220 kV Kosova B, dhe instalimi i ndriçimit përgjatë saj
13. Instalimi i kamerave vëzhguese (CCTV) në NS Kosova B dhe Depo;
14. Furnizimi dhe Instalimi i Mbrojtjeve rele numerike në fushat Autotransformatorike në NS Kos B;
15. Furnizim me transformator te fuqisë;

Bazuar në Planin Investiv, Departamenti për Menaxhim të Projekteve & Inxhinieri gjatë vitit 2013 ka përgatitur specifikimet teknike, të cilat janë dorëzuar në prokurim për projektet e mëposhtme:

1. Instalimi i TR 3 dhe pajisjeve të tensionit të lartë në NS Deçani :
 - a. *Bazuar në Marrëveshjen për Kycje KOSTT / KelKos për kycjen e Gjeneratorëve me ujë në rrjetin e Transmisionit; Investues KelKOS dhe me një shumë prej 65.000€ investim i KOSTT për shpenzime vetjake ;*
2. Instalimi i TR 2 ne NS 110/10(20) - Skenderaj dhe instalimi i TR në NS Burim;
3. Përfshirja e të gjitha ndryshimeve në nënstacionet ekzistuese si dhe inkorporimi i nënstacioneve të reja në SCADA/EMS në Qendrën Dispeçerike dhe në Qendrën Emergjente Dispeçerike;
4. Instalimi i grupeve matëse në kufirin e ri mes KOSTT dhe KEK/OSSH;
5. Instalimi i transformatorit të tretë në NS 110/10(20) kV Prishtina 2;

Pas përfundimit të afatit garantues, në vitin 2013 në pronësi të KOSTT nga KEK(KEDS) janë bartur edhe tri nënstacione të reja 110/10(20) kV: NS Gjilani 5, NS Palaj , NS Prishtina 7, për të cilat u bë edhe pranim dorëzimi i dokumentacionit.

Komisioni i Bordit të Drejtorëve të KOSTT-it për Projekte Kapitale, e ka përcjellur statusin e projekteve gjatë mbledhjeve që janë mbajtur gjatë vitit 2013.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 16 nga 78</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

2. Raporti i Kryeshefit Ekzekutiv

2.1. Arritjet kryesore

Në mesin e detyrave të KOSTT dhe në përputhje me objektivat e saj strategjike, një nga detyrat kryesore mbetet edhe më tutje ofrimi i shërbimeve kualitative dhe të besueshme për përdoruesit e sistemit të transmisionit. Në këtë drejtim, performanca e operimit të sistemit të transmisionit në vitin 2013 ka pasur ngritje të theksuar.

Linjat dhe nënstacionet janë mirëmbajtur sipas planit të paraparë, duke realizuar 93 % të aktiviteteve të ekipeve të mirëmbajtjes së nënstacioneve dhe 98% të mirëmbajtjes nga ekipi i linjave e që është brenda normave të realizimit. Aktivitetet kryesore të cilat janë përfshi në planin e mirëmbajtjes janë: kontrollimi i autotransformatorëve dhe transformatorëve, kontrollimi me termovision i nënstacioneve dhe linjave, shqyrtimi i rregullt i fushave , shqyrtimet e shpenzimeve vetjake dhe të mbrojtjeve rele të transformatorëve të fuqisë, remonti i fushave dhe linjave.

Përveç kësaj, janë ndërmarr një mori aktivitete që kanë ndikuar në ngritjen e performancës, si komisionimet e ndryshme në NS Ferizaj 1, NS Gjilani 1, NS Lipjani Linja LP 112/1 dhe LP 112/2 dhe në dy linja ajrore në NS Prizreni 2. Disponueshmëria e linjave, përkatësisht autotransformatorëve gjatë realizimit të remonteve dhe intervenimeve përkatësisht implementimit të remonteve për nivelet e tensionit të cilat i disponojmë, është në nivel të kënaqshëm.


Implementimi i suksesshëm i projekteve do të ndihmojë në përmbushjen e objektivave themelore të KOSTT, në rradhë të parë, në rritjen e kapacitetit të transmetimit, modernizimin e sistemit dhe mirëmbajtjen preventive, gjë që do të ndikojë në rritjen e besueshmërisë dhe sigurisë së sistemit, që është në përputhje me vizionin dhe misionin e KOSTT.

Zhvillimi i infrastrukturës fizike është përcjellë edhe me zhvillimin e infrastrukturës ligjore dhe rregullative. Dizajni i Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës (DTEEK) është miratuar nga ZRRë në fillim të vitit, ndërsa Drafti Final i Rregullave të Tregut i është dorëzuar ZRRë për aprovim në Dhjetor 2013 dhe të njëjtin muaj edhe janë aprovuar.

Opinionin e auditorit të jashtëm për pasqyrat financiare për vitin 2012, i cili për të shtatën herë, është pa asnjë kualifikim, dëshmon më së miri punën profesionale dhe përkushtimin e KOSTT në zbatimin e standardeve më të larta në proceset e punës dhe përmblylljen me shumë sukses të shfrytëzimit të të gjitha resurseve. Poashtu, KOSTT ka kryer me kohë obligimet ndaj klientëve dhe Institucioneve të shtetit të Kosovës.

Janë aprovuar shumë dokumente të rëndësishme, politika dhe procedura në harmoni me dispozitat e Ligjit të Punës.

Të arriturat e KOSTT, respektivisht, progresi që KOSTT ka bërë gjatë vitit 2013, janë paraqitur më detalisht në pikën 2.4 të këtij Raporti, i cili shqyrton implementimin e Planit të Biznesit për vitin 2013.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 17 nga 78</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

2.2. Ngjarjet kryesore të vitit

1. Projekti për termocentralin Kosova e Re

Gjatë vitit 2013, KOSTT ka vazhduar angazhimin në kuadër të Komitetit Drejtues projektin për ndërtimin e termocentralit Kosova e Re në kaudër të grupeve punuese lidhur me çështjet kyçe të vazhdimin të projektit, duke dhënë kontributin e vetë lidhur me aspektet e transmisionit dhe tregut të energjisë.

2. Vizita nga Banka Botërore dhe Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH)

Në fillim të muajit shkurt KOSTT-in e kanë vizituar delegacionet e Bankës Botërore dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim më të cilët është diskutuar për mundësitë e bashkëpunimit në zhvillimin e infrastrukturës së transmisionit dhe mbështetjes në zhvillimin e KOSTT. Hapja e këtyre mundësive të bashkëpunimit vjen si rezultat i anëtarësimit të Kosovës në EBRD dhe rezultateve të punës së KOSTT. Më hollësisht BERZH ka shprehur gatishmërinë që të kreditoj KOSTT për projektet zhvillimore. Gjithashtu edhe Banka Botërore ka shprehur gatishmërinë të kreditoj KOSTT për projekte të cilat ndërlidhen me energjinë e ripërtitshme.

Këto kontakte kanë vazhduar edhe në tremujorin e dytë.

3. Vizita në Austri

Gjatë muajit shkurt në Vjenë është mbajtur një takim me Drejtorin e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë dhe Udhëheqësin e USAID për Energji për EJL ku është diskutuar për sfidat me të cilat ballafaqohet KOSTT, dhe mundësinë e ndërtimit të tregut të përbashkët Kosovë-Shqipëri, me ç'rast u mbështet iniciatiava e KOSTT për tregun e përbashkët.

4. Vizita në Norvegji


Gjatë muajit dhjetor me ftesë të ambasadës së Norvegjisë në Kosovë dhe asaj në Shqipëri, një delegacion nga përfaqësuesit e institucioneve të sektorit të energjisë në Kosovë dhe Shqipëri kanë vizituar Norvegjinë, përkatësisht OST e Norvegjisë, ministrinë përkatëse dhe rregullatorin e energjisë ku është diskutuar për mundësitë e bashkëpunimit reciprok.

5. Studimi për sigurinë e furnizimit

Me 26 mars 2013 është organizuar tryezë e punës ku u prezantua Studimi mbi Sigurinë e Furnizimit me Energji Elektrike në Kosovë (SFEE). Objektivi e Studimit ishte analizimi i disa skenareve për të parashikuar zhvillimin e kërkesës për energji elektrike në vend, adekuacinë e gjenerimit të energjisë elektrike, funksionimin e tregut të energjisë elektrike si dhe shfrytëzimin e burimeve të ripërtitshme, të gjitha këto elemente që ndikojnë në sigurimin e furnizimit me energji elektrike në Kosovë deri në vitin 2030.

6. Vazhdimi i aktiviteteve për tregun e përbashkët Kosove – Shqipëri

KOSTT ka vazhduar aktivitetet për tregun e përbashkët Kosovë – Shqipëri, duke hartuar kornizat e studimit të ardhshëm të fizibilitetit. Në ndërkohë KOSTT do të vazhdojë

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 18 nga 78</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

intensifikimin e përpjekjeve për jetësimin e këtij projekti me sigurimin e mjeteve për realizimin e studimit.

7. Miratimi i dizajnit të tregut të energjisë

Zyra e Rregullatorit të Energjisë me 1 mars 2013 ka miratuar Dizajnin e tregut të energjisë elektrike në Kosovë. KOSTT ka vazhduar me hartimin e rregullave të tregut në pajtim me dizajnin e ri.

8. Projekti i linjës 400kV Kosovë – Shqipëri

Në tremujorin e parë, KOSTT dhe OST me pëlqimin e ministrive përkatëse të Kosovës dhe Shqipërisë kanë vendosur që të anulojnë tenderin për ndërtimin e linjës 400kV Kosovë-Shqipëri (Lot 1) gjë për të cilën është pajtuar edhe KfW. Lidhur me këtë vendim janë njoftuar edhe ofertuesit të cilët kanë marrë pjesë në tender. KOSTT ka angazhuar një kompani konsulentë për të kryer një analizë të tregut dhe arsyeshmerisë për zhvillimin e negociatave me ofertuesin e parë apo përsëritjes të tenderit.

Takimet me OST dhe KfW kanë vazhduar edhe në tremujorin e dytë dhe aktivitetet paraprake kanë rezultuar me fillimin e negociatave të kontratës me Dalekovodin, për të cilën edhe KfW ka dhënë pëlqimin e vet.

Me 14 qershor, është nënshkruar kontrata për implementimin e Lot 2 të projektit të Linjës 400kV Kosovë – Shqipëri, përkatësisht komponenta e LFC. Kontrata do të hyj në fuqi pas miratimit nga ana e KfW, e që lidhet edhe me definimin e implementimit të pjesës së linjës edhe nga ana e Shqipërisë.

9. Përfundimi i projektit të asistencës teknike nga Komisioni Evropian (KE)

Projekti i asistencës për KOSTT i cili është financuar nga Komisioni Evropian ka përfunduar në fund të muajit mars. Ky projekt ka qenë mjaft i dobishëm për KOSTT, në hartimin e dokumenteve teknike si dhe në ofrimin e mbështetjes në proceset tjera afariste të KOSTT.


10. Dialogu teknik ndërmjet Kosovës dhe Serbisë

Kanë vazhduar bisedimet teknike për energji ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, ku ka marrë pjesë edhe menaxhmenti i KOSTT. Bisedimet kanë rezultuar me nënshkrimin e marrëveshjes ndërmjet dy kryeministrave.

Parim bazë i kësaj marrëveshjeje është që aranzhmanet përkatëse duhet të janë në pajtim me ligjet e Kosovës, ku Serbia njeh KOSTT si OST e Kosovës dhe zotohet se do të mbështesë KOSTT në procesin e anëtarësimit në ENTSO-E.

KOSTT dhe EMS do të nënshkruajnë marrëveshje bilaterale, me të cilën do të shfuqizohen marrëveshjet paraprake teknike të nënshkruara ndërmjet UNMIK dhe Serbisë.

Kosova dhe Serbia do të mundësojnë licencimin e operatorëve të njëra tjetrës në legjislacionet përkatëse. KOSTT do të jap udhëzime për operatorët e NS Vallac. Në anën tjetër në veri të Kosovës në pajtim me ligjet në fuqi do të mund të themelohet një kompani e cila do të kryente funksionet e furnizimit dhe inkasimit për KEDS.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 19 nga 78</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

11. Takimet me përfaqësuesit e USAID-it

Takim me përfaqësuesit e USAID te ngarkuar për energji dhe infrastrukture Evropë dhe Azi Steven S.Burns, lidhur me mbështetjen buxhetore dhe logjistike për zhvillimin e tregut të përbashkët Kosovë- Shqipëri

12. Marrveshja për Kycje - KELKOS

Në tremujorin e dytë është firmosur Marrëveshja për Kycje me KELKOS për kapacitetet hidrike në Deçan.

13. Marrveshja për kycje me Zatric(Gjeneratore me erë)

Janë zhvilluar aktivitetet me investitorin për parkun e gjeneratorëve me erë për dhënjën e kycjes në lokacionin Zatriç (45MW)

14. Task Force

Është mbajtur takimi me zyrtarët e lartë të KEDS dhe KEK për të përcaktuar mënyrën e operimit pas shthurjes në mes të tyre. Është formuar Task Force për të punuar në balancimin e sistemit.

Mbledhja e fundit e Task Forcës Takimi për koordinim operativ ka pasur për temë furnizimin e qëndrueshëm gjatë zgjedhjeve lokale 2013, nën koordinimin e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik dhe për të siguruar furnizim më të qëndrueshëm gjatë zgjedhjeve komunale 2013, është mbajtur një takim i përbashkët KOSTT, KEK dhe KEDS si dhe janë ndërmarrë masa për mbarëvajtje të furnizimit. Lidhur me këtë KOSTT do të shërbej si qendër koordinuese në rast nevojë.

15. Miratimi i tarifave

Pas miratimit të të hyrave 2013-2017 nga ZRRE, miratohen tarifatat për vitin 2013.

16. Financimi i projekteve (Kredia nga BERZH dhe KfW)

Është iniciuar procesi për sigurimin e mjeteve nga BERZH dhe KfW për financimin e projekteve kapitale sipas planit investiv dhe Planit të Biznesit të KOSTT. KOSTT ka zhvilluar takime me KEDS lidhur me harmonizimin dhe koordinimin e investimeve.


Gjatë tremujorit të tretë janë finalizuar marrëveshjet për projektet të cilat parashihen të financohen nga kjo kredi. Në tetor me BERZH janë diskutuar projektet e propozuara për financim dhe ka filluar faza e vlerësimit të KOSTT në përgjithësi dhe projekteve në veçanti. BERZH ka shprehur gatishmëri dhe fleksibilitetet me qëllim të përshpejtimin të procedurave që KOSTT të angazhoj mjetet e veta për shërbimet teknike të cilat do të reimbursehen KOSTT.

17. Rehabilitimi i fasadës së ndërtesës afariste të KOSTT

Ka filluar projekti për rehabilitimin e fasadës së ndërtesës afariste të KOSTT.

18. Komercializimi i fijeve optike

Banka Botërore ka treguar gatishmëri për të analizuar mundësitë për komercializimin e tepriçës së fijeve optike në linjat e transmisionit, duke mos cenuar sigurinë e sistemit.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 20 nga 78</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

Takimi me homologët në Shqipëri

Në tremujorin e katërt është mbajtur një takim me partnerët në Shqipëri, OST dhe KESH, lidhur me marrëveshjen me Serbi, përkatësisht nënshkrimin e marrëveshjes për operim ndërmjet OST dhe EMS, dhe janë marrë zotimet nga pala shqiptare se ata nuk do të nënshkruajnë marrëveshje e cila do të cenonte integritetin e KOSTT.

20. Vizita në KOSTT e delegacionit nga OST

KOSTT ka pritur për një vizitë të delegacionit të OST nga Shqipëria të kryesuar nga Zëvendës Administratori i OST. Qëllimi i vizitës ka qenë njoftues dhe informues për zhvillimet e fundit dhe diskutimi për intensifikimin e bashkëpunimit.

21. Grupi punues për ligjet e energjisë elektrike

Përfaqësuesit e KOSTT ka marrë pjesë aktive në Grupin punues për amendamentin e ligjeve të energjisë për të përmbushur kërkesat e Pakos së tretë të BE.

22. Prezantimi nga USAID

KOSTT ka marrë pjesë në një prezantim/tryezë pune të organizuar nga USAID me pjesëmarrje të KOSTT, KEK, KEDS dhe ZRrE, ku janë diskutuar çështjet e rregullimit dhe tarifave në sektorin e energjisë elektrike në Kosovë.

23. Udhëtimi studimor për kyçjet e gjeneratorëve me erë

Një grup ekspertësh të KOSTT në kuadër studimit të financuar nga BERZH për kyçjet e kapaciteve me erë në rrjetin e transmisionit kanë marrë pjesë në një vizitë studimore në Gjermani.

24. Prezantimi në Vjenë në konferencën e investitorëve

KOSTT ka marrë pjesë në konferencën e investitorëve të organizuar nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë ku ka prezantuar arritjet e deritanishme, sfidat me të cilat ballafaqohemi si dhe investimet e planifikuara në sistemin e transmisionit.

25. Pjesëmarrja në takimin ndërministror Kosovë – Maqedoni (MZHE-ME)


KOSTT ka marrë pjesë në takimin ndërministror Kosovë – Maqedoni, përkatësisht Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik të Kosovës dhe Ministrisë së Ekonomisë së Maqedonisë, ku janë diskutuar edhe çështjet e ndërlidhura me transmision. Pritet që në ditët në vijim të nënshkruhet marrëveshja për operim ndërmjet KOSTT dhe MEPSO.

26. Implementimi i marrëveshjes për energji me Serbinë

Janë zhvilluar aktivitete intensive për hartimin e planit të implementimit, ka progres për disa çështje, plani i implementimit pritet të miratohet nga kryeministrat e Serbisë dhe Kosovës. Në bazë të planit akcional, pritet që të gjitha anekset të nënshkruhen deri me 25 shkurt 2014, ndërsa implementimi të përfundoher deri me 1 qershor 2014.

27. Negocimi i kontratës kornize me EMS në Vjenë


Me 10 dhjetor 2013 me ndërmjetësimin e Komisionit Evropian dhe Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, dhe në bazë të marrëveshjes për Energji ndërmjet Kryeministrit të Kosovës dhe atij të Serbisë, në Vjenë është mbajtur takimi ndërmjet KOSTT dhe EMS

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 21 nga 78</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

ku është negociuar marrëveshja kornizë për operim me EMS. Në këto negociata është definuar që KOSTT do të operoj si zonë kontrolluese në kuadër të bllokut rregullues Serbi- Mal i Zi – Maqedoni me të drejta të barabarta, si dhe aranzhmanet tjera të ndërlidhura. Marrëveshja si e tillë nuk është nënshkruar, por vetëm harmonizuar dhe pajtuar ndërmjet KOSTT dhe EMS, dhe mbetet që strukturat relevante politike në Kosovë dhe Serbi të japin pëlqimin për nënshkrimin e saj, gjë që nuk ka ndodhur deri me sot.

28. Nënshkrimi ceremonial i kontratës për linjën 400kV Kosovë – Shqipëri

Me 21 Dhjetor 2013, në praninë e Ministrit të Zhvillimit Ekonomik të Kosovës z.Fadil Ismajli, dhe Ministrit të Energjetikës dhe Industrisë të Republikës së Shqipërisë z.Damjan Gjoknuri, dhe Ambasadorit të Gjermanisë në Kosovë z.Peter Blomeyer, në hapësirat e Lidhjes së Prizrenit në Prizren është bërë nënshkrimi ceremonial i kontratës për ndërtimin e linjës interkonektive 400 kV Kosovë-Shqipëri.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 22 nga 78</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>


2.3. Pasqyrë e performancës operative dhe rezultatet e indikatorëve kyç të performancës

2.3.1. Balanca e planifikuar dhe i realizuar për Janar-Dhjetor 2013


Muajt MWh	Janar-Dhjetor 2013		
	E planifikuar	E realizuar	Real/Plan%
(1) TC Kosova A	1 846 112	2 014 046	109.10
(2) TC Kosova B	3 752 919	3 863 439	102.94
(3) Energjia për shpenzime vetanake (TC A+TC B)	0	0	
(4) HC Ujmani	80 000	99 387	124.23
(5) HC Lumbardhi	26 661	29 707	111.42
*(6)= 1+2+3+4 Prodhimi në hyrje të transmisionit	5 679 031	5 976 872	105.24
(7) Devijimi	0	6 931	
(8) Eksporti	473 441	856 869	180.99
(9) Importi	615 135	521 712	84.81
(10) = 6-7-8+9 Energjia në disponim	5 820 725	5 634 784	96.81
(11) Distribucioni	4 761 154	4 606 524	96.75
(12) Ferronikeli	526 680	403 704	76.65
(13) Sharri	67 800	59 439	87.67
(14) Trepça	27 106	24 549	90.57
(15) Mihjet dhe konsum.jasht KEK	140 400	145 553	103.67
(16) Shpenzimet vetanake të TC nga transmisioni(LP290,B1,B2,T12,T34,T35,T45)	171 700	284 679	165.80
(17) = 11+12+13+14+15+16 Kërkesa neto	5 694 840	5 524 448	97.01
(18) Humbjet në transmission	125 885	110 336	87.65
(19) =17+18 Kërkesa gjithsej	5 820 725	5 634 784	96.81

Të dhënat e planifikuara janë marrë nga dokumenti Balanca Vjetore e Energjisë Elektrike 2013, ndërsa të dhënat e realizuara nga pikat matëse dhe të transferuara në kufi të Kosovës.


Të dhënat në tabelë janë ilustruar edhe në diagramin vijues:


	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 23 nga 78</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

Balanca e planifikuar Janar-Dhjetor 2013





Balanca e realizuar Janar-Dhjetor 2013



	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 24 nga 78</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>


Diagrami i balancës së realizuar elektroenergjetike Janar- Dhjetor 2013 (GWh)



	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 25 nga 78</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

2.3.2. Indikatorët Kyç të Performancës – operimi i sistemit

Nr	Indikatori		Janar-Dhjetor	Janar-Dhjetor	2013/2012(%)	Caku	Komentë
			2012	2013			
T1	Kapaciteti i Disponueshëm Mesatar Import/Eksport(AATC)						I paaplikueshëm për shkak që KOSTT nuk është anëtare e ENTSO-E
T2	Kapaciteti i Disponueshëm Maksimal Import/Eksport MATC						I paaplikueshëm për shkak që KOSTT nuk është anëtare e ENTSO-E
T3	Koha mesatare e ndërprerjes (AIT minuta/periudhen e raportimit)		304.0	671.19	220.65	Caku vendoset sipas raportit: (AIT për periudhen aktuale)/(AIT për periudhen e kaluar) < 1	AIT ka qenë më e madhe për periudhen Janar-Dhjetor 2013. Rreth 75% e energjisë së pafurnizuar ka qenë më plan, për shkak të ndërprerjeve gjatë implementimit të projekteve të KOSTT dhe për shkak të punimeve të autostrades.
T4	Numri i ankesave për tension		1	3		Nr i përgjigjeve / Nr ankesave =1	Caku për ankesa për tension duhet të ndërlidhet me numrin e ankesave në vitin (et) paraprak në periudhen e njëjtë dhe mundësia e zgjidhjes së ankesës duhet të jetë në kohë sa më të shkurtë.
T5	Numri i ankesave për matje		0	0			

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 26 nga 78</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

T6	Vlera mesatare absolute e devijimeve orare Programi (MWh/orë)	Import	33.94	28.94	85.25	20MWh/h tërheqje jashta programit të deklaruar	Stafi i Qendrës së Kontrollit ka për qëllim që devijimet mesatare absolute në orë të programeve të importeve/eksporteve të jenë sa më të vogla. Gjatë vitit 2013, krahasuar me 2012 vlera mesatare e devijimeve si import ka qenë për 14,75% më e vogël, ndërsa në eksport për 1,5%,
		Eksport	30.71	30.25	98.50	20MWh/h shtyerje jashta programit të deklaruar	
T7	Humbjet në transmision (GWh)		108.51	110.34	101.68		Humbjet e energjisë elektrike në transmision kanë qenë për 1,68 % më të mëdha në vitin 2013 krahasuar me atë të vitit 2012.

AATC-Average Available Transmission Capacity


MATC-Maximum Available Transmission Capacity

$AIT = (8760 * 60 * ENS) / TE$

ENS-Energy not supplied - EPF-Energjia e pafurnizuar


TE-Transmitted energy - ET- Energjia e transmetuar (Energjia që hyn në transmision) është energjia e cila hyn në transmision nga prodhimi i gjeneratorëve (Prodhimi në prag të transmisionit) dhe importeve si rrjedha fizike nga linjat interkonektive (import flow).

AIT- Average interruption time - KMR - Koha mesatare e rënieve


	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 27 nga 78</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

2.3.3. Indikatorët Kyç të Performancës - operimi i transmisionit


Nr	Indikatori	Niveli i tensionit	2012	2013	Krahasimi	Caku	Komenti
		kV	Janar-Dhjetor	Janar-Dhjetor	2013/ 2012	≤ 1	
T1	Numri i prishjeve në linja në 100km gjatësi	400	0.00	0.53	0	≤ 1	
		220	1.30	0.43	0.330769231		
		110	1.40	0.98	0.7		
T2	Koha mesatare e riparimit të prishjes në linjë(orë)	400	0.00	4.03	0	<1	
		220	3.11	2.29	0.736334405		
		110	13.23	8.03	0.606953893		
T3	Koha mesatare e shkyçjes për shkak të mirëmbajtjes së linjës (minuta)	400	0.00	0	0	< 1	
		220	0.00	0	0		
		110	0.00	0	0		
T4	Numri i prishjeve në transformator në 100 transformator(njësi)	400/220(110)	0.00	0	0	< 1	
		220/110	0.00	8.46	0		
T5	Koha mesatare e riparimit të prishjes në transformator(orë)	400/220(110)	0.00	0.24	0	< 1	
		220/110	0.00	4.11	0	< 1	

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 28 nga 78</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

T6	Koha mesatare e shkyçjes për shkak të mirëmbajtjes së transformatorit (minuta)	400/220(110)	0.00	0	0	< 1	
		220/110	0.00	5	0		
T7	Numri i prishjeve në stabilimente të TL në 100 fusha	400	0.01	1	100	> 1	<ol style="list-style-type: none"> 1. Dëmtimi TMRR-së në fushën e TR-1 në fazën One NS Prizreni 1 2. Eksplozimi i TMRR ne NS Lipjani ne fushën e TR1 faza 0 3. Eksplozimi e nje TMRR ne NS Prizreni 3 ne fushën e TR2
		220	0.00	1	0		
		110	1.57	5	3.184713376		
T8	Koha mesatare e riparimit të prishjes në stabiliment (orë)	400	4.25	0.024	0.000564706	> 1	
		220	1.00	0.1	0.1		
		110	4.41	1.4	0.31731641		
T9	Koha mesatare e shkyçjes për shkak të mirëmbajtjes së stabilimentit(fushës)(minuta)	400	0.00	0	0	< 1	
		220	0.00	0	0		
		110	0.00	0	0		
T10	Numri i prishjeve në mbrojtje rele/kontroll në 100 fusha	400	10.00	0	0	< 1	
		220	0.00	0	0		
		110	0.00	0.769	0		
T11	Koha mesatare e riparimit të prishjes në mbrojtje rele/kontroll (orë)	400	0.25	0	0	< 1	
		220	0.00	0	0		
		110	0.00	12	0		

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 29 nga 78</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

T12	Koha mesatare shkyçjes për shkak të mirëmbajtjes së mbrojtjes rele/kontrollit (minuta)	400	0.00	0	0.00	<1	
		220	0.00	0	0.00		
		110	0.00	821.591	0.00		

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 30 nga 78</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

2.3.4. Operimi i tregut

Tregu i energjisë elektrike në Kosovë është treg bilateral dhe i rregulluar ku mungon konkurrenca në tregun me shumicë dhe atë me pakicë. Ekziston vetëm një furnizues që furnizon konsumatorët e rregulluar dhe ata të pa rregulluar.


Për shkak të mungesës së konkurrencës dhe furnizuesve të tjerë të pavarur dhe në bazë të ligjeve të reja lejohet që konsumatori i kualifikuar të furnizohet nga Furnizuesi Publik me çmim të rregulluar i cili ndryshon nga niveli i tensionit ku ata janë të kyçur. Feronikeli furnizohet nga KEDS me çmim të rregulluar në nivelin 220kV. Prandaj madhësia e tregut që i referohet segmentit të rregulluar në nivelin 220kV do të paraqitet si raport i energjisë së konsumuar në nivelin 220kV në raport me konsumin e përgjithshëm në Kosovë e shprehur në diagramet më poshtë.

Tranziti i energjisë elektrike në periudhën Janar-Dhjetor' 13 në rrjetin e KOSTT ka qenë 1.902.218 MWh gjegjësisht 23% e rrjedhave fizike të energjisë nëpër rrjetin transmetues. Edhe më tutje KOSTT nuk kompensohet për këtë shërbim nga mekanizmi i ITC por kompensohet EMS (TSO e Serbisë).


Sipas vlerësimeve të KOSTT, energjia elektrike e reduktuar në vitin 2013 është mesatarisht 0.75% e konsumit vendor, nga 2.54% sa ishte në vitin 2012.

Konsumi tarifor në nivelin me pakicë në vitin 2013, i furnizuar nga rrjeti 110kV, ka qenë 4.720.219MWh apo 85% i konsumit total ka dalë nga rrjeti transmetues që ishte 5.595.946MWh.

Tregu i rregulluar dhe i pa-rregulluar





Energjia që ka hyrë në rrjetin transmetues



Energjia që ka dalë nga rrjeti transmetues dhe humbjet në transmision

Pjesëmarrja e konsumit tarifor dhe jo tarifor



	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 33 nga 78</i>
<i>Departamenti Financiar</i>	<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>	

2.3.5. Pasqyra e performancës financiare dhe rezultatet

Në vazhdim, janë paraqitur Draft Pasqyrat Financiare (të pa audituara)

Draft Bilanci i Gjendjes 31.12.2013

		Viti 2012	Viti 2013	% e realizimit 2013/2012
	Note	(EUR 000)	(EUR 000)	
Palujtshmëritë, impiantet dhe pajin	4	112,538	121,680	108%
Investimet në vijim	5	2,155	5,191	241%
PASURITË JOQARKULLUESE		114,693	126,871	111%
Stoqet, pjesët rezervë dhe veglat	6	1,838	2,594	141%
Arkëtueshmëritë dhe kërkesat tjera	7	11,554	3,670	32%
Huatë, avanset dhe depozitat	8	733	1,999	273%
Tatimi në të hyra		-	-	
Paraja në arkë dhe bilanci bankar	9	18,062	21,507	119%
PASURITË QARKULLUESE		32,187	29,771	92%
TOTAL AKTIVA		146,880	156,642	107%
KAPITALI AKSIONAR DHE REZERVAT				
Kapitali aksionar	10	25	25	100%
Kapitali i trashëguar	11	38,322	53,172	139%
Fitimi për periudhën e mëhershme		15,368	15,157	99%
Fitimi i mbajtur/1-12/2013		2,789	3,805	136%
		56,504	72,160	128%
DETYRIMET JO KURENTE				
Të hyrat e shtyera	12	81,709	77,900	95%
DETYRIMET KURENTE				
pagueshmëritë dhe obligimet tjera	13	8,667	6,583	76%
KONTIGJENTE DHE ZOTIME				
		90,376	84,482	93%
		146,880	156,642	107%


	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 34 nga 78</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

DRAFT PASQYRA E FITMIT DHE HUMBJES

		Viti 2012	Viti 2013	% erealizimit 2013/2012
	Note	(EUR 000)	(EUR 000)	
Të hyrat operative		21,524	24,611	114%
Të hyrat nga Tarifat	15	15,636	17,812	114%
Të hyrat tjera operative	16	5,888	6,800	115%
Shpenzimet operative		18,402	20,404	111%
Shpenzimet e stafit	17	3,950	4,458	113%
Amortizimi	4	8,769	9,547	109%
Riparime dhe mirëmbajtje	18	667	1,051	158%
Humbjet e energjisë	21	3,433	3,427	100%
Provizioni për dëmtim të inventarit	22	106		
Shpenzimet tjera operative	19	1,477	1,922	130%
Fitimi para tatimit		3,122	4,207	135%
Të hyrat nga interesi				
Tatimi		333	402	121%
Neto fitimi për periudhë		2,789	3,805	136%

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 35 nga 78</i>
Departamenti Financiar		Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti

	Viti Paraprak (2012)	Viti Tanishëm (2013)	
DRAFT RRJEDHA E PARASË NGA AKTIVITETET OPERATIVE	(EUR 000)	(EUR 000)	
Fitimi gjatë vitit	3,122.00	4,206.98	135%
Përshtatjet për:			
Provizionimi i stoqeve			
Të hyrat nga interesi	(617.00)	(604.23)	98%
Shlyerja e mjeteve themelore.	88.00	16.34	19%
Amortizimi i palujtshmërive, impianteve dhe pajisjeve	8,769.00	9,546.58	109%
Të hyrat e shtyera	(5,262.00)	(5,896.70)	112%
Provizioni për dëmtim të inventarit	106.00		0%
Shpenzimi i tatimit në fitim	560.00	402.00	72%
Rrjedha operative e parasë para lëvizjeve në kapitalin punues	6,766.00	7,268.96	107%
Rritje e Stoqeve nga Grantet			
Rritje në stoqe, pjesë rezervë dhe vegla	(290.00)	(756.29)	261%
Rritje në Arkëtueshmëri dhe kërkesa tjera	(3,964.00)	4,997.61	-126%
Rritje në hua, avanse dhe depozite	2,458.00	(187.68)	-8%
Rritje në pagueshmëri dhe obligime tjera	1,222.00	(2,084.37)	-171%
Gjenerimi i parasë nga aktivitetet operative	6,192.00	9,238.23	149%
Pagesa e tatimit në të hyra			
Paraja neto nga aktivitetet operative	6,192.00	9,238.23	149%
RRJEDHA E PARASË NGA AKTIVITETET INVESTIVE			
Të hyrat nga BK-donacion kesh			
Pagesa e donacioneve-Kthimi i Mjeteve në Buxhetin e Kosovës			
Intersi i pranuar	617.00	604.23	98%
Blerja e aseteve të reja	(18,414.00)	(6,397.25)	35%
Paraja neto nga aktivitetet investive	(17,797.00)	(5,793.02)	33%
Grantet e pranuar	11,557.00		0%
Rritja neto e parasë dhe ekuivalenteve të parasë	(543.00)	3,445.21	
Paraja dhe ekuivalentet e parasë (me 2013-01-01)	18,605.00	18,062.04	97%
Paraja dhe ekuivalentet e parasë (me 2013-12-31)	18,062.00	21,507.25	119%

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 36 nga 78</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

DRAFT PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL				
Perfundimisht 01.01.2013-31.12.2013.				
	Kapitali aksionar	Kapitali i trashëguar	Fitimi i mbajtur	Total
	----- EUR -----			
Kapitali aksionar në para	(25)			25
kontributet tjera jo para		(53,172)		53,172
Fitimi për periudhën e mëhershme				15,157
Fitimi i muajve të mëhershëm				-
Shtesat e share premium				
Fitimi për periudhë			3,805	3,805
Bilanci me DATA	(25)	(53,172)	3,805	72,160

Informacionet për vitin financiar 2013

Të hyrat operative gjatë vitit 2013 kanë qenë 24,611,000 euro dhe janë për 14.3% më të larta në krahasim me vitin paraprak, ndërsa shpenzimet operative janë realizuar në vlerën prej 20,404,000 euro dhe janë për 10.9 % më të larta në krahasim me vitin e kaluar.

Të hyrat e realizuara nga tarifa janë në vlerë prej 17,812,000 euro dhe janë për 13.9% më të larta në krahasim me vitin paraprak, ndërsa të hyrat tjera operative në vlerë prej 6,800,000 euro janë për 15.6% më të larta se në vitin 2012.

Fitimi para tatimit për vitin 2013 është në vlerë 4,207,000 euro.


Asetet joqarkulluese janë në vlerën prej 121,680 mijë euro, pasuritë qarkulluese 29,771,000 euro dhe gjithësejt pasuria e KOSTT sh.a. në vitin 2013 është në vlerën 156,642,000 euro.

Kapitali aksionar dhe rezervat janë në vlerën prej 72,160,000 euro, detyrimet afatgjata (të hyrat e shtyera) 77,900,000 euro dhe detyrimet afatshkurtëra 6,583,000 euro.

Nga të dhënat e prezantuara, shihet se pasuria e KOSTT është financuar nga:

- 46.07% kapitali i akcionarit
- 49.73% grante qeveritare dhe grante tjera
- 4.20% detyrime afatshkurtëra


Struktura e kapitalit nuk ka ndryshuar dhe është e rritur vetëm për vlerën e fitimeve të mbajtura.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 37 nga 78</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

2.3.6. Analiza e IKP-ve financiare

Në vazhdim, janë dhënë IKP-të që paraqesin performancën financiare të KOSTT-it gjatë vitit 2013.

Treguesit	I-XII 2012	I-XII 2013	Shpjegimet
T1. Fitimi operativ marginal = Fitimi neto /gjithsejtë të hyrat	0.13	0.16	Qëllimi është që të jetë mbi zero .
T2. Treguesi i likuiditetit = kapitali punues/detyrimet qarkulluese	3.71	4.04	Treguesi duhet të jetë më i madh se 1 .
T3. Treguesi i qarkullimit te kërkesave =kërkesat *365 ditë/të hyrat	153 ditë	31 ditë	Caku: ≤ 90 ditë
T4. Treguesi i efektit te kapitalit te investuar (ROCE) = fitimi neto/mesatarja e kapitalit të investuar mesatarja e kapitalit të investuar = Total asetet- obligimet	2.02	2.56	Caku: > 0
T5. Giring =borxhi total afatgjatë/kapitali			Aktualisht, KOSTT nuk ka borxh afatgjatë. Caku: < 60%

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 38 nga 78</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

2.4. Progresi me Planin e Biznesit

Për të analizuar progresin e KOSTT me Planin e Biznesit, në vazhdim do të cekem: roli, misioni dhe vizioni.

Roli i KOSTT-it është që të operojë sistemin e transmisionit dhe tregut të energjisë elektrike në Kosovë. Përgjegjësitë e KOSTT-it janë përcaktuar me ligjet e energjisë (Ligjin për Energji, Ligjin për Energjinë Elektrike dhe Ligjin për Rregullatorin e Energjisë) dhe në licenca. Poashtu, përgjegjësi e KOSTT-it është edhe bashkëpunimi me operatorët e sistemit të shteteve fqinje në marrëveshjet rajonale.

Roli i KOSTT-it është që të operojë sistemin e transmisionit dhe tregut të energjisë elektrike në Kosovë. Përgjegjësitë e KOSTT-it janë përcaktuar me ligjet e energjisë (Ligjin për Energji, Ligjin për Energjinë Elektrike dhe Ligjin për Rregullatorin e Energjisë) dhe në licenca. Poashtu, përgjegjësi e KOSTT-it është edhe bashkëpunimi me operatorët e sistemit të shteteve fqinje në marrëveshjet rajonale.

Misioni i KOSTT-it është që të sigurojë që të ofrojë shërbime cilësore duke implementuar teknikat dhe teknologjitë më të avancuara për zhvillimin e sistemit të transmisionit, të sigurojë transparencë dhe të mos diskriminojë mes shfrytëzuesve të sistemit të transmisionit në një treg konkurrues të energjisë elektrike dhe të promovojë qëndrimet e kompanisë në nivel rajonal dhe evropian.

Në përputhje të plotë me vizionin e vet, KOSTT synon që “Të jetë kompani financiarisht e qëndrueshme dhe fitimprurëse, e cila siguron transmision të sigurt dhe të besueshëm të energjisë elektrike, e përgjegjshme në kuptim social dhe mjedisor dhe e integruar me rrjetet dhe institucionet evropiane të transmisionit të energjisë elektrike“.

Për të realizuar synimet e përcaktuara, janë vendosur edhe objektivat, pjesa dërmuese e të cilave janë objektiva strategjike dhe të cilat do të hasen edhe në planet e biznesit edhe për disa vite me rradhë.

Objektivat para së gjithash kanë të bëjnë me sigurimin se KOSTT-i është një organizatë efektive, e aftë për të përballuar sfidat me të cilat do të përballlet në të ardhmen.

Objektivat e vendosura të KOSTT për vitin 2013 janë:

1. Planifikimi, zhvillimi dhe ndërtimi efektiv i sistemit transmetues të energjisë elektrike;
2. Avansimi i mirëmbajtjes së sistemit të transmisionit;
3. Siguria dhe besueshmëria e sistemit të transmisionit;
4. Krijimi i kushteve për operimin dhe zhvillimin e tregut të energjisë elektrike në pajtim me zhvillimet e pritura;
5. Qëndrueshmëria financiare;

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 39 nga 78</i>
Departamenti Financiar		Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti

6. Pjesëmarrja aktive në proceset e zhvillimit të tregut rajonal (të përfitojë nga zhvillimi rajonal dhe të kontribuojë në të);
7. Anëtarësimi në ENTSO-E dhe mekanizmat tjerë ndërkombëtarë;
8. Vendosja e marrëdhënieve efektive me palët e interesit;
9. Të jetë punëdhënës atraktiv, që investon në zhvillimin profesional të punonjësve të vet;
10. Të jetë kompani e përgjegjshme në aspektin social dhe mjedisor;
11. Të krijojë një ambient të sigurt pune.

Pikërrishtë nga këto objektiva të lartcekura, do të analizohen të arriturat e KOSTT gjatë vitit 2013, respektivisht, implementimi i këtij Plani të Biznesit.

Edhe këtë vit, performanca e operimit të sistemit të transmisionit ka pasur ngritje të theksuar. Nuk ka pasur prishje të transformatorëve, është zvogluar numri i prishjeve në linja dhe nuk ka pasur prishje me ndikim në sistemin e kontrollit, monitorimit, telekomunikimit, mbrojtjes rele në rrjetin transmetues.²

Gjatë vitit 2013, janë realizuar 93 % të aktiviteteve të ekipeve të mirëmbajtjes së nënstacioneve dhe 98% të mirëmbajtjes nga ekipi i linjave e që është brenda normave të realizimit. Aktivitetet kryesore të cilat janë përfshi në planin e mirëmbajtjes janë: kontrollimi i autotransformatorëve dhe transformatorëve, kontrollimi me termovision i nënstacioneve dhe linjave, shqyrtimi i rregullt i fushave, shqyrtimet e shpenzimeve vetjake dhe të mbrojtjeve rele të transformatorëve të fuqisë, montimi i fushave dhe linjave, etj. Përveç kësaj, janë ndërmarr një mori aktivitete që kanë ndikuar në ngritjen e performancës, si Komisionimet e ndryshme në NS Ferizaj 1, NS Gjilani 1, NS Lipjani Linja LP 112/1 dhe LP 112/2 dhe në dy linja ajrore në NS Prizren2. Disponueshmëria e Linjave përkatësisht Autotransformatoreve gjatë realizimit të remonteve intervenimeve përkatësisht implementimit të remonteve për nivelet e tensionit të cilat i disponojmë është në nivel të kënaqshëm.

Janë bërë avansime në ngritjen e funksioneve operative në monitorimin dhe veçmas në operimin e sistemit në kohën reale. Duke filluar nga viti 2011 është mundësuar monitorimi dhe kontrolli në kohën reale i pjesës më të madhe të rrjetit transmetues të R.Kosovës. Pjesa e pa përfshirë në këto mundësi është pjesa veriore ku për shkak të njohura ende nuk është mundësuar përfshirja në këtë paket e NS Vallaq dhe HC Ujmani, pastaj nënstacionet e reja të ndërtuara dhe transformatorët e shtuar në ato ekzistuese, të implementuara pas përfundimit të projektit të SCADA\EMS & Telekom. Megjithatë, pas vendimit të Qeverisë për kalimin e aseteve të NS 110/x kV së bashku me shërbimet përcjellëse nga KEK në KOSTT, për operim dhe kontroll të sistemit duhet të zgjerohet niveli i kontrollit dhe monitorimit deri në kufirin e ri. Kjo do të funksionalizohet në

² Shih Tabelën e Inikatorëve Kyç të Performancës së operimit të transmisionit në pikën 2.3.3 të këtij Raporti

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>fajqe 40 nga 78</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

vazhdimëi dhe po ashtu do të përfshihen edhe ndryshimet e tjera në rrjetin transmetues për shkak të zhvillimeve të rrjetit.

Sistemi infrastrukturor SCADA\EMS, i Telekomit dhe Matjeve komerciale ofrojnë mundësi shumë më të avansuara për operim të sigurisë së lartë, në baza planifikuese dhe në kohë reale, këmbimin e të dhënave midis objekteve elektro-energjetike, TSO-ve fqinje dhe Qendrës Koordinative të Bllokut Rregullues. Që nga shtatori 2013 është duke u shfrytëzuar platforma për parashikim të konsumit nacional “Load Forecast”, e cila po gjeneron rezultate relativisht të mira, duke pas parasysh mos përfshirjen e tërësishme të rrjetit transmetues të Kosovës në SCADA\EMS.


Infrastruktura e matjeve komerciale ka përmirësuar në masë të konsiderueshme leximin e të dhënave kumulative të energjisë elektrike në të gjitha pikat kufitare të rrjetit transmetues përmes përdorimit të Fibre Optikut në pronësi të KOSTT-it.

Poashtu, është punuar në zhvillimin e strategjisë për hyrje në tregun e telekomunikimeve, duke ofruar tepricën e kapaciteteve fiber optike. Si rezultat i kësaj pune u përpilua Plani i Biznesit për Operimin e shërbimeve të infrastrukturës në tregun e telekomunikimeve, e cila ishte edhe parakusht për përgatitjen e dokumentacionit përkatës për aplikim për autorizim/licencë. Tani, kjo është licenca e tretë e KOSTT-it, së bashku me licencën për Operator të Sistemit të Transmisionit dhe licencën për Operator të Tregut të energjisë elektrike, që kanë të bëjnë me biznesin themelorë të KOSTT-it. Dy licencat e para janë marr pas themelimit të KOSTT-it si rrjedhojë e procesit të ristrukturimit të sektorit të energjisë në Kosovë.

Nga aspekti i sistemeve SCADA/RTU janë bërë një varg ndërhyrjesh në riparimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të sistemeve të SCADA-ve ekzistuese si ndërrimin e HMI-ve, monitorëve, BCU-ve, përfshirjen e të dhënave të reja në SCADA lokale në pajtim me llojet e pajisjeve primare të zëvendësuar. Është bërë edhe testimi periodik i funksionalitetit të Qendrës Emergjente Dispeçerike, i cili ka rezultuar me sukses.

Janë bërë edhe shumë veprime të tjera të cilat kanë ndikuar në ngritjen e besueshmërisë së sistemit, të cilat janë dhënë në vijim:

- Funkcionalizimi i plotë i Qendrës Nacionale Dispeçerike Emergjente (rezervë),
- Krijimi i kushteve të interkonektimit me fibër optik me TSO-on e Maqedonisë për komunikime inter-TSO,
- Funkcionalizimi i plotë i qendrës për menaxhimin dhe monitorimin në kohë reale të infrastrukturës telekomunikuese NMS (Network Management System), kryesore në QND dhe asaj rezervë në QNDE, si dhe i radio sistemit telekomunikues,
- Instalimi i 20 RTU-SCADA sistemeve në nënstacione 110 kV/X kV, të cilat së bashku me sistemet ekzistuese të SCADA e furnizojnë me të dhëna sistemin SCADA/EMS,
- Lëshimi në punë i sistemit SCADA në NS 400/110 kV Ferizaj 2 (prodhim i SIEMENS), NS 110/35kV Palaj dhe NS 110/10kV Skënderaj,
- Montimi i modemave me adaptera për komunikim përmes rrjetit fiber optik,
- Me ndihmën e inter-fejseve (ndërlidhjeve) TCP/IP dhe rrjeteve ethernet, është mundësuar integrimi HVM në rrjetet lokale të KOSTT, duke shmangur shfrytëzimin e rrjeteve të jashtme publike (GSM) dhe njëkohësisht duke zvogëluar koston e shfrytëzimit të tyre,
- Me ndihmën e inter-fejseve TCP/IP, rrjeteve ethernet dhe centralit telefonik IP, është mundësuar gjithashtu integrimi i gati të gjitha objekteve elektroenergjetike në

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>fajqe 41 nga 78</i>
Departamenti Financiar		Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti

rrjetin lokal telefonik të KOSTT – VOIP (Voice over IP), duke shmangur shfrytëzimin e rrjeteve të jashtme publike (PTK) dhe njëkohësisht duke zvogëluar koston e shfrytëzimit të tyre,

- Testimi periodik i njehsorëve dhe verifikimi i klasës së saktësisë të tyre,
- Përshtatja e sistemeve matëse me Kodin e Matjeve,
- Mirëmbajtja dhe leximi i të dhënave të matura për barazim përfundimtar nga njehsorët në Qendrën për lexim nga distanca(RMC-AMR), si dhe
- Administrimi dhe Operimi në RMC (Remote Metering Center), llogaritja dhe analiza e humbjeve teknike në transmission.

Nga aspekti i monitorimit dhe kontrollit të nënstacioneve është hedhë në tender inkuadrimit i monitorimit dhe kontrollit i të gjitha ndryshimeve të bëra në nënstacione 110/X kV në kohën e implementimit të projektit “SCADA/EMS dhe Telekomunikacioni” LOT2 si dhe inkuadrimit i monitorimit dhe kontrollit të pajisjeve deri në kufirin e ri KOSTT-KEDS. Tenderi është në fazën e evalvimit. Me realizimin e këtij projekti KOSTT do të përmbyll të gjitha obligimet të veta që i ka në raport me kodin e operimit në krahasim me kufirin KOSTT-KEDS që është krijuar pas privatizimit të KEK shpërndarja.

Statusi i projekteve kapitale për 2013:

- 1) Paket Projekti SCADA/EMS & Telekom: LOT-1:SCADA/EMS, i financuar nga BK
Statusi i projektit: Është lëshuar Certifikata e Pranimit të Pjesëbëm të Përkohshëm (PPAC) për ALSTOM dhe KOMTEL për Sistemin Kontrollues të Nënstationit (DCS) në NS Prizreni 2. Është lëshuar Certifikata e Pranimit të Pjesëbëm Final (PFAC) për ALSTOM për SCADA/EMS për pjesën e caktuar të projektit, sipas përsëkrimit në PFAC.
- 2) Paket Projekti SCADA/EMS & Telekom: LOT-2: Telekom, i financuar nga BK
Statusi i projektit: Është lëshuar PFAC për pajisjet telekom., pas përfundimit të afatit garantues, përpos pajisjeve PBX për të cilat është lëshuar PPAC. Në këtë periudhë, në bashkëpunim me kontraktorët Alstom është punuar në përgatitjen për periudhën një vjeçare të mirëmbajtjes. Mjetet e paguara janë retantion money
- 3) Ndërrimi i përçuesit, izolatorëve dhe paisjeve lidhëse në LP 125/2 dhe 125/3, financuar nga buxheti i KOSTT
 - *Statusi i projektit: Projektit i kompletuar pjesërisht : LP 125/2 ka përfunduar dhe është në afat garantues ndërsa pjesa e projektit që përfshin LP 125/3 për shkak të situatës politike në pjesën veriore të Mitrovicës, nuk ka përfunduar dhe punët janë shtyrë deri në momentin kur të krijohen kushtet (viti 2015)*
- 4) Kycja e NS 110/10 kV – Lipjani në linjën LP 212 (drejtimi NS Kosova A – NS Ferizaj 2, financuar nga buxheti i KOSTT-it ;
 - *Statusi i projektit: projekti i kompletuar ,kontraktuesit i është lëshuar Certifikata e Pranimit të Përkohshëm (PAC – Provisional Acceptance Certificate) dhe është në periudhën garantuese;*
- 5) Rialokimi i linjës 110kV, nr.1806, drejtimi NS Gjakova 1 – NS Gjakova 2 dhe rehabilitimi i pajisjeve të TL në NS Gjakova 1, financuar nga buxheti i KOSTT-it;

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	ver. 1.0	faqe 42 nga 78
Departamenti Financiar	Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti	

- *Statusi i projektit: ka vonesa në implementim, si pasojë e mospërformancës së duhur të kontraktuesit në sigurimin e dokumentacionit fillestar dhe procedurave të sigurimit të Lejës Ndërtimore. Gjatë kuartalit të katërt - Q4 2013, pas marrjes së lejës për punë, kontraktori ka vazhduar me punë ndërtimore, instaluese në nënstacion. Punët janë përfunduar dikund 90 %, janë realizuar testimet SAT për pajisjet e instaluara. Me datën 03.10.2013 MMPH ka lëshuar lejën ndërtimore për punë në linjën 110kV LP 1806. Pas marrëveshjeve, dakordimeve me datën 29.10.2013 PM i KOSTT ka lëshuar certifikaten për fillimin e punëve, por aktivitetet në terren nuk ka pasë përveç liferimit të pjesërishtëm të shtyllave.*

6) Rehabilitimi i pajisjeve të tensionit të lartë 110 kV në NS Gjilani 1 dhe NS Ferizaj 1, financuar nga buxheti i KOSTT-it;

- *Statusi i projektit: projekti i kompletuar dhe është në periudhën garantuese;*

7) Instalimi i dy fushave të reja të linjave 110 kV në NS Prizreni 2, financuar nga buxheti i KOSTT-it;

- *Statusi i projektit: Në përgjithësi ka vonesa në implementim, si pasojë e mospërformancës së duhur të kontraktuesit. Projekti ka përfunduar të gjitha punët instaluese dhe SAT-i, pritet që të bëhet komisionimi.*

Projektet e reja të cilat kanë filluar me implementim në vitin 2013 janë paraqitur më poshtë

8) Shërbimet konsulente & Ndërtimi i linjës 400 kV RKS - AL - LOT 1, financuar nga KfW (donacion) dhe KOSTT (kredi);

- *Statusi i projektit: Më 12.12.13, është bërë nënshkrimi i kontratës. Vlera e kontratës së nënshkruar është 30.773.986,59 pa taksa doganore dhe TVSH. Projekti është bashkëfinancim KfW (16.500.000 Euro në total, në formë granti, duke e përfshirë edhe LFC) dhe pjesa tjetër KOSTT kredi. Pritet realizimi i pagesës së avancit si dhe fillimi i implementimit të projektit.*

9) Shërbimet konsulente & Ndërtimi i linjës 400 kV Fusha e TL dhe LFC - LOT 2 financuar nga KfW (donacion) dhe KOSTT (kredi);

- *Statusi i projektit: Me 14.06.2013 është nënshkruar kontrata në vlerë prej 5.058.112,00€. Gjatë tremujorit të katërt është bërë pagesa e avancit dhe koha e implementimit ka filluar.*

10) Rehabilitimi i stabilimenteve të TL në NS Gjakova 2, LOT 1, financuar nga buxheti i KOSTT-it

- *Statusi i projektit: Rehabilitimi i stabilimenteve të TL në NS Gjakova 2, kontrata e nënshkruar me 27.02.2013. Projekti është në fazën e implementimit.*

11) Rehabilitimi i stabilimenteve të TL në dhe Prizreni 3 Lot 2, financuar nga buxheti i KOSTT-it;

- *Statusi i projektit: Rehabilitimi i stabilimenteve të TL në NS Prizreni 3 është nënshkruar kontrata me 20.03.2013. Projekti është në fazën e implementimit.*

12) Rehabilitimi i Shtyllave të LP.2298 220kV me Nr.24 dhe 25 dhe LP.1806 110kV me Nr.31 dhe 32, financuar nga buxheti i KOSTT-it;

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 43 nga 78</i>
Departamenti Financiar		Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti

- *Statusi i projektit: Janë përfunduar të gjitha punimet, është lëshuar Certifikata për Pranim të Përkohshëm (PAC) dhe ka filluar periudha garantuese*

13) Ndërtimi i rrethojës së re në NS 400/220 kV Kosova B, dhe instalimi i ndriçimit përgjatë saj.

Instalimi i kamerave vëzhguese (CCTV) në NS Kosova B dhe Depo, i financuar nga buxheti i KOSTT-it;

- *Statusi i projektit: Janë përfunduar të gjitha punimet është lëshuar Certifikata për Pranim të Përkohshëm (PAC), dhe ka filluar periudha garantuese.*

14) Furnizimi dhe Instalimi i Mbrojtjeve rele numerike në fushat Autotransformatorike në NS Kos B, i financuar nga buxheti i KOSTT-it;

- *Statusi i projektit: është nënshkruar kontrata më datën 12.09.2013. Projekti është në fazën e implementimit, duhet të përfundoj në mars të vitit 2014.*

15) Furnizim me transformator te fuqise, i financuar nga buxheti i KOSTT-it;

- *Statusi i projektit: i kompletuar, transformatori i liferuar duhet të instalohet në NS Burimi gjatë vitit 2014*

Grupi i projekteve të cilat kanë status : të përfunduar afatin garantues dhe për të cilat është lëshuar Certifikata për Pranim Final (FAC) janë :

- Shërbime Konsulentësh për Projektin e Ndërrimit të Pajisjeve të Tensionit të Lartë në NS 220/110 kV - Prizreni 2 dhe Instalimi i Autotransformatorit ATR3 150 MVA (LOT1)
- Rehabilitimi në linjat 110kV, 126/4 (pjesa e vjetër), 179/1, 1801 (ndërrimi i izolatorëve dhe urave përçuese), financuar nga buxheti i KOSTT-it;
- Ndarja e zbarrave në dy seksione, në NS Gjilani 1 dhe NS Therandë, financuar nga buxheti KOSTT-it;
- Rehabilitimi i pajisjeve për shpenzime vetjake në NS 400/220kV – Kosova B, financuar nga buxheti i KOSTT-it;
- Furnizimi me softuerin E-Plan, financuar nga buxheti i KOSTT-it;
- Asfaltimi i rrugës së qasjes për NS 400/110 kV – Peja 3, financuar nga buxheti i KOSTT-it;

Siç mund të shihet nga përshkrimi i mësipërm, shumica e këtyre projekteve janë kompletuar ose janë futur në operim/përdorim dhe janë në fazën garantuese, kurse në anën tjetër edhe Komisioni i Bordit për Investime Kapitale e ka përcjellë statusin e projekteve, gjatë mbledhjeve që janë mbajtur gjatë vitit 2013, me ç' rast për të gjitha problemet dhe vonesat është njoftuar më kohë dhe ka dhënë rekomandime për Bordin e Drejtorëve se si të veprohet më tutje, për rastet e vonesave në projekte.

Ndërrimi i regjimit të zgjidhjes së çështjeve pronëso-ro-juridike dhe si pasojë e mospërfshirjes së kohës përkatëse për zgjidhjen e tyre në dokumentacionin tenderues, ka shkaktuar vonesa në implementim të një numri të vogël të projekteve.

Vlen të theksohet se investimet e parapara për vitin 2013 nga Donacionet janë prolonguar për vitet e ardhshme, pra nuk janë realizuar sipas planit investiv.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 44 nga 78</i>
Departamenti Financiar		Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti

Në mesin e objektivave të KOSTT, është që të jetë një kompani financiarisht e qëndrueshme. Kryerja e obligimeve me kohë ndaj klientëve dhe Institucioneve të shtetit të Kosovës, dëshmon më së miri për arritjen e synimit të KOSTT.

KOSTT ka vazhduar aktivitetet lidhur me liberalizimin e Tregut të Energjisë elektrike në Kosovë. Aktivitetet e zhvilluara ishin në përputhje me objektivat dhe kërkesat e qeverisë rreth liberalizimit të tregut të energjisë elektrike, kërkesat që dalin nga legjislacioni primar i sektorit të energjisë; kërkesat që dalin nga Traktati i Komunitetit të Energjisë dhe Direktivat e Komisionit Evropian.

Procesi rreth hartimit të Dizajnit të Tregut të Energjisë Elektrike në Kosovë (DTEEK) i filluar në vitin 2010 ka përfunduar dhe është aprovuar nga ZRrE më 01.03.2013, pas një procesi të gjatë konsultativ dhe pasi janë përfshirë edhe komentet e marra nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë (SKE) . Që të jenë në përputhje me dizajnin e aprovuar të tregut, janë modifikuar Rregullat e Tregut dhe Drafti Final i Rregullave të Tregut i është dorëzuar ZRrE për aprovim në Dhjetor 2013, ku edhe janë aprovuar.

Operatori i Tregut ka bërë testimin e IT për Treg, duke bërë popullimin me shënime të platformës dhe është regjistruar domeni www.kostt-mo.com. Procesi i Nominimit Dry-run të programeve ditore nga palët sipas metodologjisë ESS(ENTSO-E Scheduling System) përmes IT për Treg ka filluar në Maj të 2013 dhe ka vazhduar pa ndonjë problem sa i përket nominimit të palëve brenda zonës tregtare të KOSTT.

Në përmbushjen e objektivave të KOSTT në Planin e saj të Biznesit, një nga të cilat është edhe integrimi rajonal, Operatori i Tregut vazhdon edhe më tutje të ballafaqohet me shumë sfida që paraqiten në procesin e integritimit në mekanizmat rajonal . Në këtë fushë angazhimi i Operatorit të Tregut ka qenë maksimal dhe sidomos në përmblylljen e marrëveshjeve me TSO-të fqinje (Inter TSO Agreement me EMS dhe MEPSO).

Njëra nga objektivat strategjike të definuara në Planin e Biznesit të KOSTT, është edhe përkujdesja për shëndetin e punëtorëve të saj. Për këtë qëllim, KOSTT ka vazhduar edhe në vitin 2013 me projektin e sigurimit shëndetësor për të gjithë punëtorët me mjete buxhetore të kompanisë. Sigurimi shëndetësor do të ndikojë në motivimin e punëtorëve për punë dhe me këtë, KOSTT do ta përmbushë objektivën strategjike, për të qenë punëdhënës atraktiv.

Në harmoni me objektivin e përgjegjshmërisë nga aspekti social, KOSTT ka ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurinë për punëtorët e saj, duke i siguruar kushtet e mira të punës në bazë të standardeve më të larta, siç janë renovimet e ndërtesës, masat e ndërmarra për parandalimin e rreziqeve në punë dhe paisjet mbrojtëse në punë.

Përgjegjësinë e saj nga aspekti social, KOSTT e ka dëshmuar edhe duke ofruar mbështetje financiare për shkollim, duke siguruar bursa për studentë dhe mbështetje financiare për kryerjen e praktikës profesionale për studentë.

Për të qenë një punëdhënës atraktiv dhe për të siguruar përmirësimin e vazhdueshëm të performancës në punë, KOSTT ka investuar në zhvillimin profesional të punëtorëve me realizimin e trajnimeve, pjesëmarrjen në seminare, workshope dhe grupe punuese.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 45 nga 78</i>
Departamenti Financiar		Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti

Duke pasë parasysh se një nga objektivat e kompanisë është edhe përgjegjësia në aspektin mjedisor, KOSTT ka treguar një përkushtim të vazhdueshëm, me largimin e materialeve të rrezikshme për shëndetin nga objektet ekzistuese, duke i kushtuar rëndësinë e merituar efikasitetit të energjisë me përdorimin e materialeve termike. Është bërë inspektimi/monitorimi në teren i objekteve, aseteve, ekipeve të mirëmbajtjes gjatë realizimit të projekteve, angazhimi mbi zhvillimin e projektit për riciklimin e mbetjeve nga letra, plastika dhe qelqi, përcjella gjatë procesit të largimit të eternitit me bazë asbesti nga fasada e vjetër e ndërtesës së KOSTT-it sipas ligjit për mbrojtje të mjedisit dhe udhëzimeve administrative nga MMPH, etj. Edhe këtë vit, ka KOSTT ka vazhduar me krijimin e hapësirave të reja për punë dhe hapësirave të gjelbëruara në NS, gjë që tregon se edhe më tutje ka vazhduar përkujdesja ndaj ambientit të punës në tërësi.

Ndërlidhur me procesin e menaxhimit të cilësisë, KOSTT është ricertifikuar për Menaxhim të Cilësisë sipas standardit ISO 9001:2008, përfshirë të gjitha NS-të e KOSTT, është realizuar integrimi i rrjetave të NS 110kV/x me rrjetin e KOSTT përmes infrastrukturës komunikuese, si dhe ka filluar implementimi praktik i projektit DMS (Sistemit për Menaxhimin e Dokumentacionit) dhe Arkivës Elektronike.

KOSTT-i operon brenda një kornize rregullative të bazuar në ligje, licenca dhe në legjislacionin sekondar të miratuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji (Zyra e Rregullatorit të Energjisë -ZRRrE). Korniza rregullative tangon KOSTT-in në shumë drejtime dhe raportet e tij me ZRRrE-në do të jenë kyçe për suksesin e KOSTT-it. Në këtë drejtim, janë dërguar në afatin e paraparë të gjitha raportet e rregullta dhe sipas kërkesave të ZRRrE-së.

Nga perspektiva e planit të biznesit, aspekti më i rëndësishëm rregullativ është përcaktimi i të hyrave të lejuara dhe tarifave. Në bazë të Rregullit për Vendosije të Çmimeve të Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe të Tregut, KOSTT ka dorëzuar te rregullatori propozimin për të hyrat maksimale të lejuara për vitin 2014

KOSTT konsideron se gjatë kryerjes së veprimtarive të saj të përditshme, vend të veçantë zënë marrëdhëniet efektive me palët e interesit, e që njëkohësisht paraqesin një nga objektivat e saj strategjike. Prandaj, KOSTT edhe këtë vit ka vazhduar me ndërtimin dhe zhvillimin e raporteve korrekte, në rradhë të parë me aksionarët (Qeverinë e Kosovës), me palët e interesuara e posaçërisht me ZRRrE, donatorët (Komisioni Evropian, KfW, USAID, etj), OST-të fqinje, përdoruesit dhe më gjërë, por edhe me institucionet financiare relevante.

Me që KOSTT eksiston dhe vepron në rrethinën e vet afariste, ndryshimet që vijnë nga kjo rrethinë, domosdo, kanë reflektim dhe ndikim edhe në afarizmin e kompanisë.

Situatë të re në rrethinën afariste paraqet shthurja dhe privatizimi i rrjetit të shpërndarjes dhe furnizimit të KEK-ut dhe transferi i Shpërndarjes dhe Furnizimit të konsorciumi privat Çalik&Limak i realizuar në maj të 2013.


KOSTT-i për sa i përket rrjetit të transmisionit përveç te transformatorët 110/35 dhe 110/10(20)kV të transferuara nga KEK-u, në pjesën tjetër ka zhvilluar infrastrukturën e

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 46 nga 78</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

nevojshme për të u përgjigjur kërkesave të kompanisë private të Furnizimit dhe Shpërndarjes.

Në rethinën afariste të KOSTT, ka ndikuar edhe kalimi i asetëve 400/220/110 kV dhe transformatorëve 220/35/10(20) kV dhe 110 kV, si dhe i fushave përkatëse me ndërprerësit e transformatorëve 35 kV dhe 10 (20) kV nga KEK sh.a në KOSTT, sipas Vendimit të Qeverisë së Kosovës, të datës 03 Gusht 2011. Kjo nënkupton domosdoshmërinë e ndërmarrjes së masave dhe aktiviteteve për të siguruar furnizim stabil dhe të sigurtë me energji elektrike gjatë dimrit të vitit 2013/2014 pasi që investimet në këto nënstacione 110/x kV nga KEK nuk kanë qenë të i mjaftueshme. KOSTT posedon “Politikën e Mirëmbajtjes “ mbi bazën e të cilave mirëmban të gjitha pajisjet e sistemit, si dhe përmbushë obligimet në respektimin e rregullave, normave dhe kodeve teknike. Deri më tani Kostt ka ndërmarrë të gjitha aktivitetet dhe masat preventive të nevojshme në mënyrë që asetet e transferuara nga KEK, të kenë një siguri më të madhe të operimit. Njëkohësisht është dukë investuar në rehabilitimin e këtyre NS-ve sipas prioriteteve të caktuara në bazë të gjendjes funksionale të tyre. Qëllimi kryesor i mirëmbajtjes është që të sigurojë një shkallë të lartë të besueshmërisë dhe sigurisë në sistemin elektroenergjetik. Kështu, përmes aktiviteteve të duhura në sistem është arritur të krijohet një stabilitet i qëndrueshëm në funksionimin normal të sistemit. Duke iu falënderuar kësaj, si dhe investimeve të shumëta, KOSTT ka kaluar nga mirëmbajtja emergjente në mirëmbajtje preventive.

Për KOSTT-in, edhe më tutje mbetet prioritet avancimi i sistemit të mirëmbajtjes sipas standardeve më të larta, të cilat kanë filluar të zhvillohen në sistemet e avansuara, duke u bazuar në gjendjen e pajisjeve, në mënyrë që të kursethet koha dhe kostoja e mirëmbajtjes.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 47 nga 78</i>
Departamenti Financiar		Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti

2.5. Realizimi i projekteve kryesore kapitale gjatë vitit 2013

Nr.	Emri i Projektit	Buxheti	Fincuar nga	Vlera e Kontratës	Data e fillimit	Data e kompletimit	Kontraktues	Buxheti Planifikuar 2013	Buxheti Shpenzuar Q1-Q4
1	<i>Paket Projekti SCADA/EMS & Telekom: <u>LOT-1:SCADA/EMS</u></i>	8,500,000.00 €	BKK	7,875,370.00 €	31.12.2008	30.06.2011	Alstom/Komtel (F/RKS)	582,339.75 €	177,086.56 €
2	<i>Paket Projekti SCADA/EMS & Telekom: <u>LOT-2: Telekom</u></i>	9,500,000.00 €	BKK	9,214,760.00 €	31.12.2008	30.06.2011	Enegroinvest/Alstom(B&H/F)		241,620.61 €
3	<i>Shërbime Konsulentësh për Projektin e Ndërrimit të Pajisjeve të Tensionit të Lartë në NS Prizreni 2 & Instalimi i ATR3, 150 MVA (LOT1) dhe TI për Operatorin e Tregut (LOT2)</i>	13,000,000.00€ (LOT1&2)	ECLO	634,000.00 €	05.10.2010	11.07.2012	INGEDIA (Ro)	0.00 €	0.00 €
4	<i>Ndërrimi i Pajisjeve të Tensionit të Lartë në NS Prizreni 2 & Instalimi i ATR3, 150 MVA (LOT1)</i>	10,000,000.00	ECLO	6,308,920.00 €	10.01.2011	09.07.2012	KONCAR (Hr)	0.00 €	0.00 €

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 48 nga 78</i>
Departamenti Financiar		Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti

Nr.	Emri i Projektit	Buxheti	Fincuar nga	Vlera e Kontratës	Data e fillimit	Data e kompletimit	Kontraktues	Buxheti Planifikuar 2013	Buxheti Shpenzuar Q1-Q4
5	<i>Ndërimi i përçuesit, izolatorëve dhe pajisjeve lidhëse në LP 125/2 dhe 125/3</i>		KOSTT	1,959,800.80€	01.06.2011	20.12.2011	ELSA& UKAB (Si/RKS)	593,644.00 €	322,849.98 €
6	<i>Kyçja e NS Lipjanit në linjën LP 212 (Kosova A - Ferizaj 2)</i>	1,050,000.00 €	KOSTT	1,397,094.32 €	27.06.2011	27.07.2012	UMEL (B&H)	281,065.09 €	688,209.41 €
7	<i>Ndarja e zbarrave në dy seksione në NS Gjilani 1 dhe NS Therande</i>	150,000.00 €	KOSTT	36,951.57 €	09.08.2011	27.01.2012	Ukab (RKS)	6,621.00 €	6,621.00 €
8	<i>Rialokimi i linjës 110kV, nr.1806 NS Gjakova 1 -Gjakova 2 dhe Rehabilitimi i pajisjeve të TL në NS Gjakova 1</i>	1,500,000.00 €	KOSTT	3,267,253.00 €	02.12.2011	29.06.2012 (120 ditë pune)	Ukab (RKS)/ELSA (Si)	1,770,830.90 €	989,373.32 €

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 49 nga 78</i>
Departamenti Financiar		Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti

Nr.	Emri i Projektit	Buxheti	Fincuar nga	Vlera e Kontratës	Data e fillimit	Data e kompletimit	Kontraktues	Buxheti Planifikuar 2013	Buxheti Shpenzuar Q1-Q4
9	<i>Rehabilitimi i pajisjeve të tenisonit të lartë (TL) 110kV në NS Gjilani 1 dhe NS Ferizaji 1</i>	1,150,000.00 €	KOSTT	960,031.00 €	18.02.2012	17.12.2012	Enbi-Power (Al)	325,289.94 €	332,646.60 €
10	<i>Instalimi i dy fushave të reja të linjave 110kV në NS Prizreni 2</i>	600,000.00 €	KOSTT	607,197.00 €	17.02.2012	03.08.2012	Ukab (RKS)	183,446.67 €	222,421.00 €
11	<i>LOT1: Rehabilitimi i stabilimenteve të TL në NS Gjakova 2</i>	2,100,000.00 €	KOSTT	1,973,912.00 €	27.02.2013	20 muaj kalendarak	UKAB	1,513,366.00 €	660,187.60 €
12	<i>LOT2: Rehabilitimi i stabilimenteve të TL në NS Prizreni 3</i>	2,100,000.00 €	KOSTT	1,796,234.47 €	20.03.2013	20.11.2014	Ukab	1,386,603.15 €	679,047.06 €
13	<i>Furnizimi me softuerin E-Plan</i>	50,000.00 €	KOSTT	34105.86	14.11.2012	23.11.2012	Komtel	0.00 €	0.00 €
14	<i>Rehabilitimi i Shtyllave të LP.2298 220kV me Nr.24 dhe 25 dhe LP.1806 110kV me Nr.31 dhe 32</i>	KOSTT	KOSTT	119,999.70 €	26.06.2013	24.09.2013	Elbndërtuesi - Eleganca	200,000.00	113,999.70 €

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	ver. 1.0	faqe 50 nga 78
Departamenti Financiar		Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti

Nr.	Emri i Projektit	Buxheti	Fincuar nga	Vlera e Kontratës	Data e fillimit	Data e kompletimit	Kontraktues	Buxheti Planifikuar 2013	Buxheti Shpenzuar Q1-Q4
15	<i>Rilokimi i linjave 110, 220 dhe 400kV me rastin e Ndërtimit të Autostradës "Ibrahim Rugova", segmenti 7-8-9.</i>	BK	Ministria e Infrastrukturës		21.02.2013	20.09.2013	Bechtel Enka - Energoinvest		0.00 €
16	<i>Shërbimet konsulent & Ndërtimi i linjës 400 kV RKS - AL - LOT 1</i>	30,500,000.00 €	kfW & KOSTT (kredi)	30,773,986.59 €	12.12.2013	24 muaj	Dalekovod	6,100,000.00 €	0.00 €
17	<i>Shërbimet konsulente & Ndërtimi i linjës 400 kV Fusha e TL dhe LFC - LOT 2</i>	5,500,000.00 €	kfW & KOSTT (kredi)	5,058,112.00 €	14.06.2013		ABB Gjermani	1,100,000.00 €	1,078,592.80 €
18	<i>Instalimi i TR 3 dhe pajisjeve të tensionit të lartë në NS Decani - bazuar në Marrëveshjen për Kyçje</i>	KelKos	KelKos				KelKos/Komtel	65,000.00 €	0.00 €

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 51 nga 78</i>
Departamenti Financiar		Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti

Nr.	Emri i Projektit	Buxheti	Fincuar nga	Vlera e Kontratës	Data e fillimit	Data e kompletimit	Kontraktues	Buxheti Planifikuar 2013	Buxheti Shpenzuar Q1-Q4
19	<i>Ndërtimi i rrethojës së re në NS 400/220 kV - Kosova B & Instalimi i ndriçimit përgjatë saj</i>	450,000.00 €	KOSTT	380,150.00 €	20.03.2013	166 dite pune	Shpk. REXHA	361,142.50 €	299,916.90 €
20	<i>Furnizimi dhe Instalimi i Mbrojtjeve Rele numerike në fushat Autotransformatorike në NS Kos B</i>	150,000.00 €	KOSTT	57,814.40 €	30.09.2013	14.03.2014	Siemens (At)	100,000.00 €	8,672.16 €
21	<i>Instalimi i kamerave vëzhguese (CCTV) në NS Kosova B dhe Depo</i>	100,000.00 €	KOSTT	92,805.00 €	15.03.2013	25 dite pune	INES	85,000.00 €	88,562.00 €

Shpjegim:

- Vlera totale e projekteve kapitale sipas Buxhetit të vitit 2013 (përfshirë edhe projektet që nuk janë paraqitur në këtë tabelë, pasi tabela përmban projektet kryesore kapitale) është: **22,115,400.67 €**
- Shpenzimi buxhetor për këto projekte kapitale: **8,631,682.24 €**

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 52 nga 78</i>
Departamenti Financiar		Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti

2.6. Perspektiva për vitin e ardhshëm

Si edhe deri më tani, edhe në të ardhmen, përpjekjet e KOSTT-it do të jenë të orientuara drejt realizimit të objektivave të saj strategjike (të cekura në pikën 2.4. të këtij Raporti), në përputhje të plotë me rolin, misionin dhe vizionin.

Zhvillimet kryesore që do të ndikojnë në KOSTT nga aspekti i operimit të sistemit, janë:

- Implementimi i Mekanizmit Balancues si kërkesë në Dizajnin e Tregut të Energjisë Elektrike në Kosovë. Kjo njëkohësisht do të kërkojë edukim për përdorimin dhe avansimin e platformave të ndryshme softuerike, të cilat mundësojnë aktivitetet e të gjitha entiteteve pjesmarrëse në tregun e energjisë dhe që siguron operim më eficient të sistemit elektrik. Në këtë drejtim, investimi në platforma të ndryshme softuerike është domosdoshmëri si dhe aftësimi për përdorimin e tyre është obligues (Softuer për zbatimin e moduleve që janë në SCADA/EMS, Kontrolla Frekuncë Fuqi-LFC, Balancimi i sistemit elektrik, blerja e humbjeve nga tregje, analiza e sigurisë së operimit një ditë para i njohur si DACF- Day Ahead Congestion Forecast, Softuer për mbikqyrje të çastit, paisjeve të TL të tipit T5000, E-TERRA platforma softuerike.
- Nënshkrimi i marrëveshjes për energji mes Kosovës dhe Serbisë e cila direkt do të ketë ndikim në regjimin e operimit të sistemit energjetik varësisht nga përcaktimi i dy TSO-ve
- Nevoja për adaptimet në zhvillimet e tregut të Kosovës. Kjo kërkon aftësi shtesë dhe zhvillim të procedurave të reja, konform modelit të tregut të energjisë elektrike në Kosovë dhe në përputhje me afatet e caktuara kohore. Njëkohësisht kërkohet edukim për përdorimin dhe avansimin e platformave të ndryshme softuerike, të cilat mundësojnë aktivitetet e të gjitha entiteteve pjesmarrëse në tregun e energjisë dhe që siguron operim më eficient të sistemit elektrik. Në këtë drejtim, investimi në platforma të ndryshme softuerike është domosdoshmëri dhe njëkohësisht, aftësimi për përdorimin e tyre është obligues (Softueret e përfshira në SCADA/EMS, në kuadër të të cilave janë modulet për analizat para dhe pas operative, modulet për monitorim dhe kontroll në kohën reale të SEE të Kosovës, Kontrolla Frekuncë Fuqi-LFC), platforma për operim në baza planifikuese në nivelin interkonektiv si DACF- Day Ahead Congestion Forecast, platforma për mundësimin e komunikimit autonom me TSO-ot tjera Europiane përmes infrastrukturës së telekomunikimit EH.
- Eksploatimin maksimal të infrastrukturës për monitorim dhe kontroll të SEE, me qëllim të shfrytëzimit optimal të kapaciteteve transmetuese
- Krijimi i mundësive teknike në masë të konsiderueshme për realizimin e kontrollit të objekteve të rrjetit transmetues nga Qendra Nacionale Dispečerike Kryesore dhe Emërgjente

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 53 nga 78</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

- Përfshirja e të gjitha objekteve energjetike në kuadër të infrastrukturës së SCADA\EMS
- Krijimi i kushteve teknike për monitorim të ndërsjell me TSO-të kufitare në kohën reale
- Azhurnimi i kodeve teknike në përputhje me Kodet e operimit të ENTSO-e
- Rritja e bashkëpunimit rajonal, nënshkrimi i marrëveshjeve të interkoneksionit, në përputhje me Ligjin e ri të Energjisë Elektrike dhe Politikave nga Doracakut i ENTSO-E dhe
- Operimi në nivel interkonektiv në përputhje me rregullat e ENTSO-E

Në aspektin e operimit gjatë planit afatmesëm do të implementohet edhe projekti i Kontrollit Frekuncë-Fuqi në bashkëpunim me OST-në e Shqipërisë i cili në mënyrë kuptimplote mund ta ndryshoj regjimin e operimit të sistemit elektrik që mund të reflektojë në dy variantat:

- Operimi në një zonë të përbashkët me Shqipërinë;
- Operimi me dy zona të ndara por në një Bllok rregullues me Shqipërinë.

KOSTT-i si Operator i Tregut, sipas ligjit të energjisë elektrike, është përgjegjës për propozimin e dizajnit të tregut të energjisë elektrike në Kosovë, përpilimin (draftimin) e rregullave të tregut dhe dorëzimin e tyre për miratim në ZRrE. Operatori i Tregut është përgjegjës për implementimin e Rregullave të Tregut dhe udhëheq procesin e modifikimit të tyre, varësisht zhvillimeve të tregut të energjisë elektrike në Kosovë dhe rajon.

Procesi rreth hartimit të Dizajnit të Tregut të Energjisë Elektrike në Kosovë (DTEEK) i filluar në vitin 2010 ka përfunduar dhe në fillim të vitit 2013 DTEEK është aprovuar nga ZRrE. Që të jenë në përputhje me dizajnin e aprovuar të tregut janë modifikuar Rregullat e Tregut të cilat pritet të aprovohen gjatë 2014. Kjo kërkon zhvillim të procedurave të reja, konform Rregullave të Tregut dhe në përputhje me afatet e caktuara kohore e me këtë edhe aftësi shtesë në përdorimin dhe avansimin e platformave të ndryshme softuerike, të cilat mundësojnë aktivitetet e të gjitha entiteteve pjesëmarrëse në tregun e energjisë dhe që do të sigurojë një treg transparent.

Në aspektin e operimit të tregut është planifikuar të studiohet edhe projekti i krijimit të një tregu të përbashkët Kosovë-Shqipëri.

Duke pas parasysh karakteristikat e tregut në Kosovë dhe Shqipëri dhe objektivat e qeverive për furnizim të sigurtë me energji elektrike KOSTT, ERO, ERE dhe OST kanë diskutuar dhe analizuar idenë e bashkimit të dy tregjeve në një treg të përbashkët (një zonë tregtare). Tregu i përbashkët do të jepte sinjale të duhura për investime në kapacitete gjeneruese të reja dhe llojin tyre, për investime në rrjetin transmetues dhe të shpërndarjes si dhe nga tregu i përbashkët do të përfitonin konsumatorët nga të dy vendet .

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>fajqe 54 nga 78</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

Tregu i përbashkët Kosovë- Shqipëri gjithashtu do të mundësonte hapjen e tregut të energjisë elektrike dhe do të krijonte kushte për një treg konkurrues.

Themelimi i një tregu të përbashkët për të gjitha afatet kohor është në harmoni me objektivat e BE dhe Komunitetit të Energjisë dhe kjo mund të konsiderohet si hap drejt integritimit në tregun regional të EJJL.

KOSTT-i është duke punuar me të gjitha kapacitetet e veta që si Operator i Tregut dhe i Sistemit të sigurojë që të jetë plotësisht i integruar në të gjitha komponentet e tregut rajonal, të cilat aktualisht janë duke u zhvilluar. Në veçanti KOSTT-i do të:

- Përcjellë zhvillimet në rajon rreth tregut të energjisë elektrike
- Përbushë obligimet që dalin nga Traktati i Komunitetit të Energjisë
- Jetë pjesëmarrës aktiv në të gjitha organizatat relevante rajonale dhe evropiane që kanë të bëjnë me operimin e sistemit dhe tregut;
- Sigurojë që të gjitha kërkesat e operimit rajonal mund të përbushen, posaçërisht standardet e ENTSO-E ;
- vendosë marrëdhënie të qëndrueshme me OST-të (Operatorët e Sistemit të Transmisionit) fqinje;
- Zhvillojë aftësitë e nevojshme për operimin e sistemit dhe tregut në nivel rajonal; dhe
- Kontribuoj në punën e CAO (Coordinated Auction Office) ku KOSTT është një nga themeluesit dhe aksionarët.

Gjatë vitit 2014, në KOSTT edhe më tutje do të zhvillohen aktivitetet të cilat përbushin normat dhe rregullat teknike, bazuar në planin pesë vjeçar të mirëmbajtjes në të cilin janë të përfshira elementet kryesore, të cilat janë bazë për mirëmbajtjen e stabilimenteve elektroenergjetike. Në këtë plan, prioritet i KOSTT mbetet edhe më tutje avancimi i sistemit të mirëmbajtjes sipas standardeve më të larta.

KOSTT operon brenda një kornize rregullative të bazuar në ligje, licenca dhe në legjislacionin sekondar të miratuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji, dhe në përputhje me këtë, do të zhvillohen këto aktivitete:

- Definimi dhe qartësimi i përmbytjes dhe ndryshimet e dëshirueshme në metodologjinë e tarifave për shfrytëzimin e sistemit të transmisionit
- Identifikimi i mundësive për përmirësime të produktivitetit dhe efikasitetit (para fillimit të Përshtatjeve të Rregullta)
- Zhvillimi i strategjisë për reduktimin e humbjeve në transmision
- Promovimi i implementimit eficient të planit zhvillimor nga i cili do të nxirren edhe stimulse në të hyra.

Korniza ligjore e zhvilluar për sektorin e energjisë është në pajtim me praktikat e mira të BE-së dhe siguron një autoritet të pavarur rregullatorë për energji, licenca për funksionet kryesore të sektorit energjetik, kodet teknike, standardet teknike dhe rregullat e tregut. KOSTT-i edhe më tutje është në pamundësi për t'iu përgjigjur implementimit të të gjitha kërkesave të kodeve dhe standardeve të industrisë kështu që derogimet janë të nevojshme edhe për një periudhë kohore.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 55 nga 78</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

Kompletimi dhe implementimi i Kornizës Ligjore dhe Rregullative është një ndër objektivat kryesore të KOSTT. Kompletimi i Kornizës Rregullative nënkupton përgatitjen e të gjitha dokumenteve sipas kërkesave nga legjislacioni primar dhe sekondar i Sektorit të Energjisë.

Prandaj, angazhimi i KOSTT që të implementojë Kornizën Rregullative shpie tek procesi i rishikimit të vazhdueshëm të dokumenteve, gjë që bëhet përmes procesit të monitorimit intern të implementimit të kornizës rregullative dhe procedurave të përcaktuara nga ZRrE.

Njëra nga objektivat strategjike të definuara në Planin e Biznesit të KOSTT, është përkujdesja për shëndetin e punëtorëve të saj. Për ta plotësuar përgjegjshmërinë nga aspekti social, KOSTT do të sigurojë se do të kujdeset për shëndetin e punëtorëve dhe do t'i ndërmerr të gjitha masat e nevojshme dhe do të përgatiten projekte konkrete për mbrojtjen e shëndetit për punëtorët e saj. Për këtë qëllim, KOSTT ka realizuar projektin e sigurimit shëndetësor suplementar, gjegjësisht sigurimin shëndetësor ndaras nga sigurimi shëndetësor shtetëror për të gjithë punëtorët me mjete buxhetore të kompanisë.

Sigurimi shëndetësor do të ndikojë në motivimin e punëtorëve për punë dhe me këtë, KOSTT do ta përmbushë objektivin strategjike, për të qenë punëdhënës atraktiv. Mbrojtja dhe kujdesi për shëndetin e punëtorëve gjithashtu do të ndikojë edhe në ngritjen e kualitetit të punës dhe performancës së kompanisë në përgjithësi.

Fokusi i KOSTT-it mbi sigurinë dhe shëndetin në punë, edhe më tutje do të bazohet në:

- Politikën mbi sigurinë në punë duke shprehur angazhimin në promovimin e parandalimit të aksidenteve për të gjithë punonjësit, duke përfshirë edhe ata të kontraktorëve. Finalizimin e dokumentacionit intern bazuar në ligjet dhe direktivat që rregullojnë fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë, duke përfshirë Dokumentin për Vlerësimin e Rrezikut. Pas procesit të aprovimit të dokumentacionit për sigurinë dhe shëndetin në punë, planifikohet implementimi i tij duke filluar me procesin e informimit, prezantimit, trajnimit dhe zbatimit praktik.
- Vlerësimin e vazhdueshëm të rrezikut në vendin e punës për punëtorët dhe pajisjet dhe përcaktimin e masave preventive paraparke për eliminimin apo parandalimin e tij
- Zhvillimin e trajnimeve të vazhdueshme dhe bashkëpunimin me organet përkatëse për përmirësim të vazhdueshëm
- Mbështetjen dhe informimin e vazhdueshëm për interpretimin e dispozitave ligjore
- Inspektimin dhe monitorimin e vazhdueshëm të punëve të brendshme dhe të kontraktura si dhe aktivitet intensiv të monitorimit mbi aplikimin e duhur dhe të plotë të procedurave si forma të verifikimit të brendshëm
- Përbushjen e kërkesave që dalin nga standardi OHSAS 18001:2004 dhe përafrimi i vazhdueshëm me kriteret që dalin prej tij për një certifikim të integruar me sistemin e menaxhimit të cilësisë dhe mjedisit, duke konsistuar në një përmbledheje të hollësishme të procedurave dhe udhëzimeve operative për të gjitha aktivitetet në lidhje me sigurinë. Planifikohet që deri në fund të vitit 2014 të kemi përmbushje të kënaqshme të kërkesave që dalin nga standardi OHSAS 18001:2004 në mënyrë që të kemi mundësi të nënshtrohemi një auditimi për certifikim.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 56 nga 78</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

- Vlerësimin e performancës së sigurisë si pjesë e integruar në sistemin e monitorimit të aktiviteteve
- Vlerësimin e besueshmërisë së materialeve dhe pajisjeve mbrojtëse
- Informacione intensive dhe të vazhdueshme përfshirë edhe aktivitete trajnuese për gjithë personelin për nocionet kryesore të sigurisë dhe risive, duke shfrytëzuar organizimin e takimeve, prezantimeve, programeve trajnuese etj. Në bashkëpunim me sektorin për trajnime në Departamentin e Burimeve Njerëzore, planifikohet zhvillimi i trajnimeve sipas dokumentit: Informimi, edukimi dhe trajnimi praktik për sigurinë dhe shëndetin në punë
- Kërkesën ndaj kontraktorëve gjatë kontratave për deklaratimet për përmbushjen e trajnimeve dhe informimit për gjithë personelin e pranishëm në vendin e punës, përdorimin e pajisjeve personale mbrojtëse dhe mbi rreziqet. Për pozitat specifike (projekt menaxher, inxhinier terreni etj) çertifikata trainimi, derisa për furnizimet, procedurë e miratuar për sigurinë dhe shëndetin në punë. Gjatë vitit 2014 planifikohet aprovimi i dokumentit mbi sigurinë për punën e kontraktuar dhe fillimi i zbatimit të tij për të gjithë kontraktorët të cilët lidhin kontratë me KOSTT-in. Instalimin e sistemit për sinjalizimin e zjarrit në objektet e transferuara nga KEK, si dhe avansimin e përgjithshëm të sistemit për mbrojtje nga zjarri dhe raste emergjente. Gjatë vitit 2013 është lidhur kontrata kornizë, e cila do të vazhdohet edhe për vitin në vijim.
- Angazhimin në procesin e zhvillimit të projekteve të reja dhe rehabilitimin e objekteve ekzistuese nga përgatitja e termave të referencës e deri te pranimi teknik.
- Futjen në zbatim të dokumenteve për menaxhimin e sigurisë dhe mjedisit nga stafi i brendshëm dhe nga kontraktorët.

Me këtë qasje, KOSTT-i si ndërmarrje publike, jep kontributin e vet për avancimin e cilësisë së jetesës në mjedisin e vet të drejtëpërdrejtë, si dhe në nivelin global.

2. 7. Rreziqet

Në afarizmin e KOSTT, kanë ndikim edhe rreziqet e mundshme, si pasojë e ndikimeve që vijnë nga jashtë, respektivisht nga rrethina afariste, dhe si të tilla, kanë implikimet e tyre në veprimtarinë e KOSTT.

Në vazhdim janë analizuar dhe identifikuar disa nga këto rreziqe:

- pengesë për operim të plotë të IT për Treg edhe më tuje mbetet mungesa e EIC kodit për KOSTT si zonë tregtare. Përgjigjja në kërkesën e KOSTT për t'iu lëshuar një kod nga ENTSO-E ishte se: lëshimi i "10Y" EIC kodit për KOSTT është i lidhur me zgjidhjen politike mes Kosovës dhe Serbisë të pengesat
- vështirësitë financiare nga mosinkasimi i të hyrave;
- risku rregullator në miratimin e tarifave që nuk reflektojnë koston reale;
- pamundësia e operimit, mirëmbajtjes dhe zhvillimit të një pjese të rrjetit transmetues të Kosovës, për shkak të qasjes së kufizuar në pjesën veriore të vendit, si dhe ndërhyrjes ilegale të Operatorëve serb EMS dhe EPS.
- Gjendja e aseteve të transferuara nga KEK-u

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 57 nga 78</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

Vështërsitë do të paraqiten, sepse parashtrohet çështja se kërkesave të tregut të energjisë elektrike, a do të mund të i përgjigjen gjithë ata që do të aderojnë në këtë treg. Më e theksuar si problematikë do të jetë balancimi si mekanizëm i domosdoshëm që duhet të implementohet.

Në mënyrë që të ulët ndikimi në secilin rrezik, duhet ndërmirren veprimet:


- Vazhdimi i aktiviteteve rreth evitimit të pengesave nga EMS dhe anëtarësimi sa më shpejt që është i mundur në ENTSO-E;
- Ndërrimi i regjimit të operimit të rregullimit të sistemit nga ai i Serbisë në atë vetjak dhe në bashkëpunim me Shqipërinë;
- Avancimi i operimit i sistemit të transmisionit që i paraprinë me aftësinë e sistemit elektroenergjetik të akomodojë kërkesat e shfrytëzuesve të sistemit duke ofruar shërbime të kualitetit të lartë, posaçërisht ndaj investitorëve privat të gjenerimit dhe furnizimit dhe shpërndarjes;
- Bashkëpunimi intensiv me palët e interesit duke sqaruar avantazhet e tregut të energjisë elektrike;
- Implementimi eficient i investimeve kapitale të KOSTT-it


	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 58 nga 78</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

Aneks

1. Sponzorimet dhe donacionet

Gjatë vitit 2013 KOSTT ka ndarë 13,200.00 € në emër të bursave për studentët e Universitetit të Prishtinës, në emër të shpenzimeve për studentë që kanë mbajtur praktikën në Kostt 1,476 € dhe për Universitetin Publik “Haxhi Zeka” në Pejë, 400 €. Në tërësi, janë ndarë 15,076 €.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 59 nga 78</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 60 nga 78</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

4. Raportimet sipas Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike

4.1. Pasqyra e strukturës organizative dhe ndryshimet gjatë vitit 2013

Struktura organizative aktuale është miratuar nga Bordi i Drejtorëve të KOSTT-it në korrik 2013 dhe përbëhet nga Bordi i Drejtorëve dhe Menaxhmenti.

Struktura e menaxhmentit më të lartë të KOSTT-it përbëhet nga pozitat vijuese: Kryeshefi Ekzekutiv (KSHE), Zëvendës Kryeshefi Ekzekutiv; Sekretari i Kompanisë; Zytari Kryesor Financiar dhe i Thesarit dhe Auditori i Brendshëm.

Menaxhmenti përbëhet nga udhëheqësit e departamenteve vijuese:

- Operatori i Sistemit;
- Operatori i Transmisionit;
- Operatori i Tregut;
- Inxhinieringu dhe Menaxhimi i Projekteve;
- Çështjet Ligjore dhe Rregullative;
- Financat;
- Burimet Njerëzore;
- Prokurimi;
- Drejtoria Qendrore, që mbulon Zyrën për Zhvillimin dhe Planifikimin Afatgjatë, Zyrën për Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun dhe Zyrën për Sigurinë Industriale dhe Mjedisin.

Ekzistojnë një sërë çështjesh që do të kenë ndikim në organizimin e KOSTT-it, si:

- Zhvillimi i sistemit të transmisionit nga këndvështrimi i kapaciteteve të rrjetit dhe kontrollimit të tij;
- Transferimi asetëve dhe operatorëve të nivelit 110 kV nga KEK-u;
- Nevoja për të arritur nivel më të lartë efikasiteti brenda kompanisë;

Numri i Punëtorëve

Me datën 1 Janar 2013, numri i përgjithshëm i të punësuarve në KOSTT ka qenë 374, ndërsa me datën 31 Mars 2013 numri i të punësuarve është 373, sepse gjatë periudhës tremujore, 1 (një) punëtor është pensionuar (Përgjegjësi i operimit në NS 110 kV - Prishtina 1).

Me 30 Qershor 2013, numri i punëtorëve në KOSTT ishte 370, ndërsa me datën 30 Shtator 2013 numri i të punësuarve ka rënë në 369.

Gjatë kësaj periudhe tremujore Korrik-Shtator 2013 ka pasur lëvizje të punëtorëve për këto arsye:

- 2 (dy) punëtorë janë pensionuar sipas fuqisë ligjore: Përgjegjësi i Operimit në NS 110 kV- Prishtina 2 dhe Likuidator i dokumentacionit


	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 61 nga 78</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>


- ka filluar punën punëtori i ri në pozitën Menaxher i Sektorit për Mirëmbajtje dhe Riparim të NS-ve.

Numri i përgjithshëm i të punësuarve në KOSTT me 1 tetor të vitit 2013 ka qenë 369, ndërsa me datën 31 Dhjetor 2013 numri i të punësuarve është 368, sepse 1 (një) punëtor është pensionuar sipas fuqisë ligjore (Përgjegjësi i Operimit në NS 110 kV- Bibaj).

Viti 2013 është përmbyllur me 368 të punësuar.


Në vazhdim është dhënë Organogrami – Makro Struktura organizative aktuale e KOSTT-it.




	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 63 nga 78</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

4.2. Përmbledhja dhe përshkrimi i procedurave gjyqësore


N r	Lënda nr.	Gjykata Kompetente	Paditës	I Padituri	Objekti i kontestit	Vlera e kontestit	Statusi	Statusi	
1	Lënda Civile nr. 2248/03	Gjykata Komunale në Prishtinë	Nuhi Çerkezi	KEK/ KOSTT	Dëmshpërblim për lëndim në vendin e punës	92,000.00	Seanca me dt.23.03.2009. KOSTT ka kërkuar që lënda ti dërgohet KEK-ut për shkak të kompetencës	Seanca e caktuar për dt.14.07.2009, u mbajt me vonesë, KOSTT ka dorëzuar Përgjigjen në Padi Gjykatës dhe në seancë në tërësi hedh poshtë kërkesëpadinë e Paditësit si të pabazë.Pritet Aktgjykimi.	Seanca 01.04/11, shtyhet dhe seanca e dt.21.04 për dt.12.05/11.Gjykata pjesërisht aprovon kërkesë padinë në vlerë 5000€. Ankesa e KOSTT-it në shkallë të II-të.
2	Lënda penale nr.326/05	Gjykata Komunale në Kaçanik	KOSTT	Nebih Bela, Veli Bela dhe Minir Mani	Vjedhje	2,370.00	Seanca e rradhës u caktua për datën 18.11.2008; shtyhet 30.01.;shtyhet 30.03.2009	Seanca e përfundimtare me dt.17.03/09, është mbajtur. Aktgjykimi.- është pranur, Lënda me Ankesë nga Prokurori të dt.08.04.2009.	Verifikimi i fundit i lëndës- 29.06/10, ende e pakryer. Aktvendimi i Gjykatës së Qarkut Prishtinë Ap.nr.321/2009, kthehet në Rigjykim të shk.I. Seanca e radhës me dt 18.06.2013. Kjo seancë shtyhet për dt të pacaktuar për arsye të mungesës së palës së paditur
3.	Lënda Civile nr.85/05	Gjykata Komunale në Prishtinë	Ismajl Liman	KEK/ KOSTT	Kompensim i dëmit	50,000.00	Seanca e rradhës është caktuar për datën 24.12.2008	Seanca e rradhës është caktuar për dt.10.02.2009, Mbahet seanca përfundimtare me dt.11.06.2009. Refuzohet Kërkesëpadia e Paditësit.	Lënda me Ankesë në Gj Apelit. Me Aktgjykimin Ac.1003/09, refuzohet Ankesa e palës. Lënda me Revizion në Gj.Supreme.
4	Lënda penale nr. 2406/ 06	Gjykata Komunale në	KOSTT	Ivica Filipoviç dhe	Vjedhje	15,398.00	Aktgjykimi në favor të KOSTT-it por	Verifikim me dt.11.06/09, Aktgjykimi	Miratim i pjesëshëm i Ankesës, Gjykata e Qarkut

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 64 nga 78</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>


		Prishtinë		Millorad Iliq			nuk është bërë akoma i plotfuqishëm	nuk i është dorëzuar të paditurve, nga dt.12.06, do t'i dorëzohet me polici	Pr.Propozim Ekzekutimi në afatin ligjor.
5	Lënda penale nr.320/06	Gjykata Komunale në Kaçanik	KOSTT	Burim Krivanjeva	Vjedhje e rëndë	9,120.00	Seanca e rradhës është caktuar për datën 14.11.2008	Seanca e caktuar për dt.27.01.2009 është mbajtur dhe pritet Aktgjykimi	Aktgjykimi me Ankesë, në GjQ, nga dt.19.03/09 Verifikimi i fundit 29.06.2010. Aktgjykimi i GjQ-ankesa e aprovuar pjesërisht.
6	Lënda penale 284/06	Gjykata Komunale në Lipjan	KOSTT	Avdullah Bejtullahu dhe Afrim Bejtullahu	Vjedhje e rëndë	Nuk shtë përcaktuar	KOSTT ka ushtruar Ankesën për zgjedhje të pjesërishtme (vlera e kontestit)	Lënda me Ankesë, pritet përgjigja nga Gjykata e Qarkut.	
7	Lënda civile nr. 409/06	Gjykata Komunale në Prishtinë	Hajrije dhe Milazim Zeka	KOSTT	Lirimi i banesës Hajrije dhe Milazim Zeka	nuk ka	Seanca e rradhës nuk është mbajtur, pritet caktimi i seancës tjetër	Seanca e caktuar gabimisht nga Gjykata me dt.04.01/10 (ditë pushimi).	Seanca e rradhës nuk është caktuar ende.
8	Lënda civile nr.511/00 C.nr.2888/09	Gjykata Komunale në Prishtinë	KOSTT	Fadil Hashani, Halil Selmanaj, Besnik Zhitia Valdet Vatovci etj	Lirimi i lokaleve në Kurriz	nuk ka	Kontesti ka përfunduar pozitivisht për KOSTT-in. Pritet Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë	Aktgjykimi është marrë, në proces është propozimi për ekzekutim. Ende nuk është kryer. (Paraprakisht marrëveshja me palët për lirim të Lokaleve). Lënda me Ankesë GjQPr. KOSTT, ka parashtruar Urgjencë GJQarkut-PR.Urgjenca e dytë 06/12.	Seanca e radhës me dt. 26.04.2013. Parashtrësë për shtyrje te seancës nga ana e KOSTT-i t dt 22.04.2013 Seanca me datë 21.06.2013. Mbahet seanca pergaditore pas të cilës Gjyqetari kërkoi prova te reja ndërsa Seanca e radhës për shqyrtimin kryesor është caktuar me dt 9.09.2013. Në mungesë të palës së paditur, seanca shtyhet për dt 7.10.2013. Në këtë

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 65 nga 78</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

									seancë për vonesën nga ana e KOSTT-it Gjyqtari me Aktvendm vendos se lënda është e përmbyllur. Është dorëzuar parashtrës që lënda të kthehet në rishqyrtim
9	Lënda civile nr. 2168/04	Gjykata Komunale në Prishtinë	KEK dhe KOSTT	Kadri Rukovci	Lirim i lokalit nga gjellëtorja në Kurriz	nuk ka	Seanca e rradhës është caktuar për datën 19.11.2008	Dalja në vend me Gjykatën, dt.23.04/09, pritet Raporti i Ekspertit. Seanca e rradhës me dt.17.04/09, (Përfaqëson KEK-u. Pengohet puna e Ekspertit nga Pala. Njoftohet Gjykata. KOSTT parashtron Urgjencë në vazhdimin e çështjes GjK-Pr.	Seanca e dt.12.02.2013 shtyhet për dt 25.02.2013, mungon pala e paditur. Në këtë seancë Gjyqtari kërkon precezimin e padisë. Seanca e datës 13.03.2013 kërkohet ripërsëritja e ekspertit te ndërtimtarisë.
10	C.156/09	Gjykata Komunale Prizren	KOSTT	Qamil Kabashi	Kompenzim dëmi		I parashtruar me dt.11.03/09.	Pritet caktimi i seancës së rradhës. Seanca e radhës caktohet per dt 19.11201.	.Kërkohet nga Paditësi KOSTT sjelljen e provave në seancën e radhës me dt 17.12.13. Gjyqtari kërkon nga palët sipas propozimit të palës së paditur të bien në ujdj gjyqësore në seancën e radhës me dt 5.02.2014
11	Lemda Civlie C.nr.0571/11	Gjykata Komunale Skenderaj	Shefqet Duli	Kostt/ Komuna Skenderaj	Kompenzim dëmi	10.000	Lemda bie në kompetencë të Gjykatës së Mitrovicës Mbahet Seanca e	Seanca është mbajtur nga kostt janë prezantuar dy deshmitar. Seanca e radhës me dt25.03.13.	

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 66 nga 78</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>


							datës 5. 12.2012. Parashtrësë Gjykatës me dt 21.01.2013 Senaca e radhës mbahet me dt 5.01.2012	Në seancën e dt 25.03.13 deklarojnë dy dëshmitar dhe kërkohet nga Gjykatësi me aktvendim te shikohet a ka pas konkurs të hapur nga kostt. Seanca e radhës me dt 16.01.2014.	
12	C.nr.1559/06	Gjykata Komunale Prishtinë	Selvije Dedinca,etj.	KOSTT	Pagesa e Rentës.		KEK ka paguar - Qershor/2006.	Seanca e 06.05; 04.06, 08.07 dhe shtyhet 26.10/10 KOSTT ka dhënë dëshminë mbi legjitimitet pasiv. Seanca e radhës me dt.30.04.2013. Per arsye te mungeses se paditures se dytë KEK seanca shtyhet per datë 27.07.2013.. seanca e radhës me datë 12.09.2013 Gjyqtari kërkon dorëzimin Aktit juridik mbi ndarjen KEK-KOSTT.Seanca e radhës 11.10.2013.	Seanca mbahet në të cilën dorëzohen provat dhe për verifikimin e tyre seanca e radhës caktohet me dt 11.11.2013. Është dorëzuar Parashtrësja për mos pjesëmarrje në këtë seancë për shkak të angazhimit në lëndën PM.nr.27/13 në Gj.Th.Pejë. Gjykata merr vendimin final në favor të pales paditëse. KOSTT dërgon ankesën në Gjykatën e shkallës së dytë,

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 67 nga 78</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>


13	C.nr. 270/07	Gjykata Komunale Podujevë	Mustafe Hasani etj	KOSTT	Kompenzim dami	100.000,€	KOSTT- I padituri III-të (Tretë) seancat e dt:10.09; dhe 12.10/10 dorëzimi i shkresave të lëndës KOSTT-it Seanca e rradhës sipas ftesës se dt.05.11.2012, Senaca shtyhet e 05.12/12, shtyhet per dt.11.01/13. Mbahet séanca dalja ne vend ngjarje për ekspetizë.	Seanca e radhës me dt 25.04.2013 Seanca e radhës me dt 25.05.2013. Shtyhet seanca për datë 28.05.2013- Seanca shtyhet për arsye të mungesës së palës nga Komuna e Podujevës për datë 26.06.13. Të paditurat kanë kundërshtuar padin dhe këkespadinë në tërsi si dhe e paditura e dytë KEK ka kerkuar dy dëshmitar në seancën e radhës e cila do të mbahet me 30.08.2013	Seanca për shkak të mungesës së ekspertit Ruzhdi Sefa dhe dëshmitarit Bedri Jahja seanca shtyhet për dt 10.10.2013.Në këtë seancë janë pyetur dëshmitari Bedri Jahja dhe eksperti Ruzhdi Sefa gjithashtu janë lexuar provat për Vendimin Final. Bie aktvendimi i Gjykatës për kompenzimin e dëmit nga ana e paditurëve për paditësin. Dorezohet ankesa kundër akrgjykimit në Gjykatën Themelore Podujevë për Gjykatën e Apelit E përfundume në shkallën e parë
14	C.nr.218/11	Gjykata Komunale Ferizaj	Fevzi Nebihu	KOSTT/ Komuna e Feruzajit	Pengim Posedi	500 €	KOSTT- ka parashtruar Përgjigje në Padi sipas Aktvendimit të Gjykatës	Seanca e dt. 20.06/11, shtyhet me 04.07; shtyhet me 05.09/11.Seanca e rradhës dt.27.10/11	Lënda e kryer në Shkallën e I-rë. KOSTT-parashtron Ankesë Gj.Qarkut-PR. Me Akvendim Gj.Apelit priset aktgjykimin i Gj.Th.Ferizaj dhe rikthen për aktgjykim .
15	C.nr.503/11	GJYKATA Komunale Pejë	KOSTT	AKP Pejë	Pengim Posedi	nn	Sipas Kërkesës së Gjykatës KOSTT ka parashtrua precizimine Padisë.	Pritet ftesa për seancë (para seancës sqarime me Gjyqtarin)	perseritet Padia, Padi e re për Vertetim Pronësie.
16	C.nr.2255/06	GjK-Prishtine	Xhemile Berisha	KOSTT	Kompenzim dëmi	nn	Sipas Kërkesës të Autorizuarit të Paditësës me	Përgjigja në Padi sipas Akt. Gjyq.u dorëzua 12.11.2011.	Seanca Gjyqsore sipas ftesës.

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 68 nga 78</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>


							zgjerrim të Padisë		
17	P.nr. 184/12	Gj.Themoloe Gjakovë	Prokuroria Gjakovë	Murteza Zhavelli	Lirim Objekti (Pushim i pa ligjshëm të pronës)	Nn	Ftohet në seancë e dt 30.10.2013 përf. Astrit Beqa si dëshmitar se i padituri a po sedon vendimin nga KOSTT për lejimin e të paditurit të qëndrojë në objektet e KOSTT –it.	Seamca me dt 30.10.2013. Ne këtë seancë është kërkuar nga Kostt sjelljen e provave konkretisht certifikatë _fletë posedimin nga Drejtoria e Kadastrit Gjakovës dhe prova tjera	Në seancën e radhës me dt 27.11.2013. janë dorëzuar provat nga ana e KOSTT-it sipas akvendimit të Gjykatës. Pritet Aktvendimi final lidhur me këtë çështje. Gjykata vendos në favor të KOSTT-it, kërkesën e KPA për largimin e puntorëve nga objekti i TS Gjakova 1 e merr si të pabazë. Lënda ka përfundar në shkallën e parë.
18	Lënda Penale P.nr.255/05	Gjykata Komunale Kaçanik	KOSTT	Atif Sopa dhe Begjet Bruti	Kompenzim dëmi	800.00		Propozim për ekzekutim të dt. 17.04.2009	
19	E.nr.281/06	Gjykata Komunale Lipjan	KOSTT	Momqillo Mitiq	Kompenzim D dëmi	2176.5	Propozim për ekzekutim te datës 11.07.2006	Lënda vazhdon në kompetencë të Gjyk. K. Prishtinë	
20	Lënda Penale P.nr. 174/07	Gjykata Komunale Kaçanik	KOSTT	Mujedin Krasniqi dhe Nexho Axhami	Kompenzim dëmi	nn	Parashtrësë Gjykatës Komunale Kaçanik te dt. 18.01.2012		
21	C.nr.244/2013*	Gjykata Themelore Prishtine	KOSTT	KEK	Kompenzim dëmi	140,285,56	Vërejtje nga Gjykata për pagesën e taksës lidhur me propozimin për caktimin e masës së sigurisë në afat prej 7 ditëve	Taksa paguhet ne Gjykatën Themelore Prishtine shuma 5000 €	

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 69 nga 78</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

22	C.nr. 0002/2012	Gjykata Themelore Mitrovicë-Dega Skenderaj	Shaban Emiri	KOSTT-Komuna Skenderaj	Kompenzim dëmi	Nn	Aktvendim nga Gjykata për pergjigje në padi. Dorezimin e parashtrësës për Gjykatën për mungesë të posedimit të padisë		
23	C.nr. 968/13	Gjykata Themelore Suharekë	Rasim Kryeziu	KOSTT-KEK	Kompenzim dëmi	Nn	Ftesëthirje për për përfaqësim në seancë me dt 28.10.2013		
24	PM.nr.27/13	Gjykata Themelore Pejë	KOSTT	Shkëlqim Muja	Kompenzim dëmi	Nn	Në mungesë të Gjyqtarës seanca caktohet me dt 11.11.2013. Seanca mbahet jepen deklaratat e palës se dëmtuar dhe pritët Vendimi me shkrim nga Gjykata.	E përfunduar në shkallën e parë	
25	P.nr.69/12	Gjykata Themelore Gjakovë	KOSTT	Haki Morina			Ftesë për seancë me dt 18.11.2013. Në këtë seancë dorëzohen provat, Gjyqtarja kërkon nga KPA prova nga ana e saj dhe seanca shtyhet për dt 09.12.2013.	Eshtë bajtë seanca përfundimtare. Pritët Aktvendimi final.Gjykata vendos në favor të KOSTT-it, kërkesën e KPA-së për largimin e puntorëve nga objekti i TS Gjakova 1 e merr si të pabazë.	E përfunduar në shkallën e parë

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 70 nga 78</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

26	C.nr.625/03	Gjykata Themelore Prishtinë	Syelejman Arifi	KOSTT	Ekspropojim	Nn	Ftesë për seancë të caktuar për dt 12.12.13. Gjykata me Aktvendim ka vendosur që lënda ka kaluar në kompetencë të KEK-ut		
27	C.nr.438/10	Gjykata Themelore Ferizaj	Kenan Mehmeti	KEK/ KOSTT	Kompenzimin e dëmet në formë të rentës	Nn	Ftohet KOSTT për përfaqësim me dt 10.01.2014		
28	Lënda Civile nr.116/2012/06	Gjykata Komunale Kaçanik	Ahmet Luzha	KOSTT	Kompenzim dëmi	nn	Pritet ftesa për seancë. Seanca e radhës me datë 21.03.2013	Ne seancën e dt 21.03.2013 kërkohet që të bëhet ekspertiza në vend. Seanca e radhës me dt: 24.05.2013.- shtyhet për datë 14.06.2013, Bëhet precezimi i ekzekutimit. seanca e radhës me 25.06.2013 . bëhet ekspertiza në vend së bashku me gjykatësin. Seanca e radhës me dt.09.08.2013	Bie ujdi me aktvendim gjyqësor. lënda përmbillet në ditën e gjykimit me datë 09.08.2013
29	Lëndë civile , Padi C.nr.190/09.e Lendes P.nr 297/07; AP.359/04	Gjykata Themelore Ferizaj	KOSTT	Asllan Krivanjeva	Kompenzimi i dëmit	200,00€ AKTV 600€	Padia e dorëzuar në Gjykatë ,26.06/09	Pritet caktimi i Seancës.	Seanca e dt.17.12/12, me Aktvendim aprovohet Kërkespafia e KOSTT-it në seancën e dt.08.01/13.. Përfundon lënda në favor të KOSTT-it

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 71 nga 78</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

30	Lënda civile C.nr.588/08	Gjykata Komunale në Gjakovë	Frrok Kaçinari	KEK- KOSTT	Kompenzim dëmi	10000	Seanca është caktuar për dt.19.01.2009	Seanca e rradhës në afat të pacaktuar KOSTT, sipas Aktvendimit C.nr.136/09 paraqet përgjigje në Padi, me dt.28.04.2009.	Në precizim të Padisë KOSTT me dt.27.03.2012, parashtron Përgjigje në Padi të C.nr.588/08 Seanca e radhës me dt 13.06.13 Bëhet Litispedenca e lëndeve. Seanca e radhës me 17.06.2013..Bie ujdj me aktvendim gjyqësor. Lënda përmbillet në ditën e gjykimit me datë 17.06.2013
-----------	-----------------------------	-----------------------------------	-------------------	---------------	-------------------	--------------	--	---	--

Lëndët e përfunduara gjatë vitit 2013


1. C.nr.116/12 – Gjykata Themelore Kaçanik – Ahmet Lluzha – e përfunduar
2. C.nr.190/09 – Gjykata Themelore Ferizaj – Asllan Krivanjeva – e përfunduar
3. C.nr.588/08 – Gjykata Themelore Gjakovë – Frrok Kaçinari – e përfunduar
4. PM.27/13 - Gjykata Themelore Pejë – Shkëlqim Muja – e përfunduar

Vlerat për kontestet gjyqësore të cilat kanë qenë të hapura deri në fund të vitit 2013 janë gjithsej:

Vlera për kontestet gjyqësore të cilat kanë qenë të hapura deri në fund të vitit 2013, për lëndet KOSTT si i paditur është: **1,399,610.00 euro**


Vlera për kontestet gjyqësore të cilat kanë qenë të hapura deri në fund të vitit 2013, për lëndet* KOSTT si paditës është: **181,770.86 euro**

* për lëndën C.nr.244/2013 nga KEK është paguar shuma e kryegjës (3,802,949.00€ sipas kërkesës për ekzekutim të padisë), ndërsa vlera e interesit prej **140,285.56 €** nuk është paguar (kamata ligjore vjetore prej 8% në vlerën e borxhit).


	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 72 nga 78</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

4.3. Kontratat/Transakcionet e konsiderueshme gjatë vitit 2013 nga burimet e KOSTT

Nr	Departamenti	Lloji i Prokurimit	Nr I Proedures	Emri I Projektit	KONTRAKTORËT	Vlera e Kontratës	Vlera e Realizuar e Kontrates	Vlera e mbetur për realizim	% e realizimit
1	Departamenti për Menaxhim të Projekteve&Inxhinieri	Procedurë e Hapur	79/2012	LOT 1: Rehabilitimi i Stabilimenteve te TL ne NS 110/10kV Gjakova 2	UKAB	1,973,912.00 €	660,487.60 €	1,313,424.40 €	33.46%
2	Departamenti për Menaxhim të Projekteve&Inxhinieri	Procedurë e Hapur	79/2012	LOT 2: Rehabilitimi i Stabilimenteve te TL ne NS 110/10kV Prizreni 3	UKAB	1,796,234.47 €	679,047.07 €	1,117,187.40 €	37.80%
3	Departamenti i Burimeve Njerëzore	Procedurë e Hapur	87/2012	Renovimi i Fasades se objektit te KOSTT-it me punet percjellese	AL TRADE	1,789,427.83 €	738,248.74 €	1,051,179.09 €	41.26%
4	Departamenti i Operatorit të Transmisionit	Procedurë e Hapur	11	Furnizimi me Pjesë Rezervë për mirëmbajtjen e Linjave dhe Nënstacioneve	XANI INEX	300,000.00 €	73,536.02 €	226,463.98 €	24.51%

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>fajqe 73 nga 78</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

5	Departamenti i Operatorit të Transmisionit	Procedurë e Hapur	7	LOT 3: Furnizim me pjese rezerve per mirëmbajtje te ndërprerësve te fuqisë të prodhuesit ABB dhe mirëmbajtje te shpenzimeve vetjake	ABB d.o.o	225,513.86 €	64,173.20 €	161,340.66 €	28.46%
6	Zyra e Sigurisë dhe Mjedisit	Procedurë e Hapur	26	Instalimi i Sistemit të sinjalizimit për mbrojtje nga zjarri dhe mirëmbajtja dhe testimi i sistemeve ekzistuese	Professional Alarm	200,000.00 €	39,203.67 €	160,796.33 €	19.60%
7	Zyra e Sigurisë dhe Mjedisit	Procedurë e Hapur	70	Furnizim me Pajisje personale mbrojtëse	Ripten Engineering	200,000.00 €	0.00 €	200,000.00 €	0.00%
8	Departamenti i Operatorit të Transmisionit	Procedurë e Hapur	73/2012	Furnizim me Pajisje te Tensionit 35kV dhe 10kV	ELECTRA	179,960.00 €	179,960.00 €	- €	100.00 %
9	Departamenti i Burimeve Njerëzore	Procedurë e Hapur	33	Furnizim me Material Higjienik	UNISERVIS	124,990.00 €	7,269.59 €	117,720.41 €	5.82%
10	Departamenti i Operatorit të Transmisionit	Procedurë e Hapur	28	Rehabilitimi i shtyllave te LP 2298 220 kV me nr.24 dhe 25 dhe LP 1806 110 kV	konz.ELBNDER TUESI&ELEGANCA	119,999.70 €	113,999.70 €	6,000.00 €	95.00%

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 74 nga 78</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>


				me nr.31 dhe nr.32					
					TOTALI	6,910,037.86 €	2,555,925.59 €	4,354,112.27 €	36.99%

Shpjegim: - Përqindja e realizimit prej 36.99 % paraqet përqindjen për dhjetë projekte më të mëdha .

Numri i projekteve të kontraktuara për vitin 2013 deri tani është 88.

Vlera e të gjitha kontratave të kontraktuara është : **8,444,010.02 €**


Realizimi total i të gjitha kontratave është **3,543,735.21 €**, që do të thotë, në përqindje 41.96 %

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 75 nga 78</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Spektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

4.4. Sygjerime dhe propozime për rritjen e performancës

Në mënyrë që KOSTT të rritë edhe më tutje performancën, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet:

- Vazhdimin të ngritjes së efijencës në mirëmbajtjen dhe operimin e sistemit të transmisionit
- Implementimin të projekteve kryesore që risin kapacitetet e operimit e që lidhen me operimin e mëvetësishëm të KOSTT;
- Vazhdimi i trajnimit të stafit dhe formave tjera të zhvillimit për përcjellje të ndryshimeve teknologjike që rritë shkathhtësitë dhe njohurit për ngritjen e efijencës në KOSTT;
- Vazhdimi i shqyrtimit të masave motivuese për stafin për ngritjen e kualitetit të punës së tyre.
- Përmirësimet në asetet e transferuara nga KEK-u dhe futja e teknologjisë për monitorim, kontroll, matje dhe operim, pajisja e të gjitha objekteve (NS-ve)
- Përgatitjet për implementimin e Rregullave të Tregut

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>fajqe 76 nga 78</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

Lista e shkurtesave

AATC - (Average Available Transfer Capacity) - Kapaciteti i Disponueshëm Mesatar (Import/Eksport)

AKP – Agjencioni Kosovar i Privatizimit

AIT – (Average interruption time) - koha mesatare e rënieve

ATC – (Available Transfer Capacity) – Kapaciteti i disponueshëm

ATR – Autotransformatori

AUK – Universiteti Amerikan i Kosovës

BCU- (Bay Controll Unit)- njësia kontrolluese

BD – Bordi i Drejtorëve

BK – Buxheti i Kosovës

BNJ – Burimet Njerëzore

CGES- (crnogorski Elektro Sistem) – OST i Malit të Zi

CHF - Franga Zvicereane

DMS-(Documents Management System) – Sistemi për menaxhimin e dokumentacionit

ECLO – (European Commission Liaison Office) - Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian

EJL – Evropa Juglindore

EKCS – Qendra Dispečerike Emergjente

EMS- (Elektro Mreza Srbije) - Rrjeti Elektrik i Serbisë

ENS- (Energy not supplied)-Energjia e pafurnizuar

ENTSO E - (European Network of Transmission System Operators for Electricity)- Rrjeti Evropian i Operatorëve të Sistemit të Transmisionit të Energjisë Elektrike

FAC- (Final Acceptance Certificate) – Çertifikata e pranimit final

GSM –(Global System for Mobile Communication) – sistemi i përgjithshëm i komunikimit mobil

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 77 nga 78</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

GJK – Gjykata Komunale

GjQ – Gjykata e Qarkut

HC - Hydrocentral

HMI – (Human Machine Interface) – ndërlidhja makinë-njeri

HVM- (High Voltage Metering) – matësi i energjisë

IKP – Indikatorët Kyç të Performancës

IPA- Instrumentet para anmtarësimit në Bashkimin Evropian

ITC – Inter TSO Compensation (Kompensimi mes Operatorëve të Sistemit të Transmisionit)

KA – Konflikt Administrativ

KCS - Qendra Dispeçerike Nacionale

KE – Kryeshefi Ekzekutiv

KEK – Korporata Energjetike e Kosovës

KfW- Banka Gjermane për Zhvillim

KOSTT- Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu

KQKO - Komiteti për Qeversje të Kodeve Teknike/Operacionale

LP – Largpërçuesi

MATC - Kapaciteti i Disponueshëm Maksimal (Import/Eksport)

MMPH – Ministria e Mjedisit dhe Planit Hapsionor

MPI – Menaxhimi i Projekteve dhe Inxhinieria

MZHE – Ministria e Zhvillimit Ekonomik

NEF (Net Export Flow) – Eksporti i Kosovës

NIF - (Net Import Flow) – Importi neto për nevojat e Kosovës

NMS – (Network Management System) – Sistemi për menaxhimin e rrjetit

NS - Nënstacioni

NP – Ndërmarrjet publike

NJPMNP – Njësia për Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike

OPGW – fibri optik

	RAPORT VJETOR	DT-FI-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>faqe 78 nga 78</i>
<i>Departamenti Financiar</i>		<i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i>

OS – Operatori i Sistemit

OST – Operator i Sistemit të Transmisionit

OT – Operatori i Transmisionit

PpE - Propozim për Ekzekutim

PZhT – Plani Zhvillimor i Transmisionit

SCADA /EMS- (System Control and Data Acquisition/Energy Managment System)
-Sistemi i kontrollit dhe grumbullimit të të dhënave/Sistemi i manaxhimit të energjisë

SSE – Sistemi Elektro Energjetik

TC A – Termocentrali Kosova A

TC B – Termocentrali Kosova B

TCP/IP – (Transport Communication Protocol) –Internet protokole të komunikimit

TE- (Transmitted energy)- Energjia e transmetuar

TKE- Traktati i Komunitetit të Energjisë

TI – Teknologjia e informacionit

TMR – Transformatori mtës i rrymës

TL – Tensioni i lartë

ToR (Terms of Reference) – Termat e Referencave

TP – Tatimi në pronë

TTC – (Total Transfer Capacity) – kapaciteti total i bartjes

USAID - (Unated States Agenci for International Development) – Agjencioni i Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar)

USEA – (US Energy Association)- Asociacioni Amerikan për Energji

ZRrE – Zyra e Rregullatorit të Energjisë

ZSZ – Zyra e Sigurisë nga Zjarri